14		Azia Jugore dhe veçoritë fiziko gjeografike	Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Azisë Jugore?	Stuhi mendimesh,	Vlerësim individual, ndër nxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.
	Di/Dua të di/ Mësoj,					
	Shkrim i lirë (punë në grupe).					

LIBRI I MËSUESIT GJEOGRAFIA 8

15		Veçoritë e popullimit, të kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore	Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore?	Diskutim, Stuhi mendimesh, lexim i orientuar/ plotësim tabele, teknika e pyetjeve.	Vlerësim individual, ndër nxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.
16		Veprimtari praktike. Rajoni i Azisë Juglindore dhe Rajoni i Azisë Jugore	Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore?	Diskutim, plotësim harte, teknika e pyetjeve, mbajtje shënimesh.	Vlerësim në grup dhe individual i përgjigjeve me gojë	Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Azisë, stilolasp, lapsa me ngjyra.
17		Australia dhe Oqeania dhe veçoritë fiziko gjeografike	Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2, 3 4. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Australinë dhe Oqeaninë?	Stuhi mendimesh, Di/Dua të di/ Mësoj, Shkrim i lirë (punë në grupe).	Vlerësim individual, ndër nxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.
18		Veçoritë e popullimit, të kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australi-Oqeani	Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullimin dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë?	Diskutim, Stuhi mendimesh, lexim i orientuar/ plotësim tabele, teknika e pyetjeve.	Vlerësim individual, ndër nxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.
19		Përsëritje	Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor hartën e të pyeturit. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.	Diagrama e Venit, diskutim, plotësim tabele.	Vetëvlerësim Vlerësim individual ndër nxënës i përgjigjeve me gojë	Teksti, harta mësimore, dërrasa e zezë, shkumësa, laptop, video-projektor, disk flipçart, fleta formati, lasp.
20		Testim (tremujori i tretë)	Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbledhës që është i detyrueshëm për çdo fund tremujori.	Punë e pavarur individuale	Vlerësim individual për secilin nxënës, Vlerësim përmbledhës	Fleta e testit me të njëjtin format për çdo nxënës.



Rajoni dhe rajonizimi

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Rajoni dhe rajonizimi		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë foton 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon termin rajon; • Klasifikon rajonet sipas elementit kryesor që mbizotëron; • Përshkruan modele nga bota që tregojnë ndërvarësinë midis vendeve dhe rajoneve. 		Fjalët kyçe: rajoni, rajonizimi	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/Tabela e koncepteve	35'
Hapi III. Përforsimi	Teknika e pyetjeve	5'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajoni dhe rajonizimi**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë foton 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Tabela e koncepteve

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mëimit, si më poshtë;

1. Rajoni në ndihmë të gjeografit
2. Vendet dhe rajonet në një marrëdhënie të ndërsjellë

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Rajoni dhe rajonizimi”**

Gjatë leximit të mëimit nxënësit plotësojnë tabelën e koncepteve si më poshtë;

Tabela e koncepteve

Rajoni	Rajonizim	Rajonet fizike	Rajonet humane	Vendet dhe rajonet në një marrëdhënie të ndërsjellë
Rajoni është një sipërfaqe toke që përfshin disa vende, të cilët kanë një ose më shumë karakteristika të përbashkëta me njëri-tjetrin, por që i dallojnë nga vendet e tjera.	Procesi i përdorimit të rajoneve për të organizuar dhe thjeshtësuar informacionet e shumta quhet rajonizim.	Rajonet fizike krijohen duke përdorur si kriter format e relievit, klimën, bimësinë natyrore etj.	Rajonet humane përdorin si kriter karakteristikat kulturore, ekonomike dhe demografike.	Rajonet fizike ndikojnë në potencialet natyrore të një vendi dhe rajonet humane në mundësinë e shfrytëzimit ose jo të tyre. Në bazë të kriterëve fizike dhe humane, hapësira tokësore oragnizohet në 11 rajone të mëdha të ndarë në më shumë nënrajone.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve. Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cila është rëndësia e rajonizimit?
2. Cilat janë kriteret që përcaktojnë ndarjen në rajone fizike dhe humane?
3. Nga dallojnë rajonet fizike nga ato humane?
4. Në ç'mënyrë vendet dhe rajonet janë në një marrëdhënie të ndërsjellë midis tyre?
5. Vëreni hartën 3 dhe lokalizoni: 11 rajonet në të cilën është e ndarë bota nga ana fizike dhe humane.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon, rajonizim, rajon fizik, rajon human
2. Vëreni foton 1 e formuloni përfundime për ç'ka ajo përfaqëson.
3. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Kërkoni të dhëna dhe përcaktoni, çfarë rajoni është vendbanimi juaj.



Rajonet fizike, tipat dhe rëndësia e tyre

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Rajonet fizike, tipat dhe rëndësia e tyre		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet fizike?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Klasifikon rajonet sipas formave të relievit; · Përcakton në hartë shtrirjen e rajoneve klimatike dhe bimorë; · Vlerëson rëndësinë e rajoneve hidrografike. 		Fjalët kyçe: rajon malor, rajon fushor, rajon klimatik, rajon bimor	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, interneti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (ese)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajonet fizike, tipat dhe rëndësia e tyre**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet fizike? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Rajonet sipas formave të relievit
2. Rajonet klimatike dhe bimorë
3. Planeti ynë ujor

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatëse si më poshtë:

- Në kolonën "Di" shkruhen informacionet kryesore të njohura;

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

- Në kolonën “Dua të di” shkruhen shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Toka është një planet me forma të larmishme. Në rajonet shkretinore kushtet e jetesës janë shumë të vështira dhe popullsia vendoset përgjatë rrjedhave të lumenjve.	-Nga ndryshojnë rajonet klimatike nga ato bimore? - Pse janë të rëndësishme rajonet hidrografike?	Rajonet fushore, malore dhe shkretinore. Rajonet klimatike dhe bimorë janë: rajoni i klimës tropikale të lagësht, i klimës së thatë dhe gjysëm të thatë me bimësi barishtore, i klimës mesatare e lagësht me pyje gjethegjërë dhe halorë, i klimës polare me tundrën, likenet.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon malor, rajon fushor, rajon klimatik, rajon bimor

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë (ese) “Mendo globalisht, vepra lokalisht”. Si e kuptoni ju këtë?

Lexohet detyra nga 4 nxënës.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 2 – 3 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Vëreni foton e formuloni përfundime për ç’ka ajo përfaqëson.
2. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Kërkoni të dhëna. Listoni ujërat minerale të vendit tonë që ju pini.



Rajonet humane, tipat dhe rëndësia e tyre

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Rajonet humane, tipat dhe rëndësia e tyre		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet humane?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan modelet e shpërndarjes së popullsisë në tokë; · Përcakton në hartë rajonet me popullsi më të lartë në botë; · Dallon rajonet e zhvilluara nga rajonet në zhvillim. 		Fjalët kyçe: rajone humane, rajone të zhvilluara, rajone në zhvillim	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, interneti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetaria, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/plotësim tabele	35'
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	5'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajonet humane, tipat dhe rëndësia e tyre**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet humane? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Modelet e shpërndarjes së popullsisë
2. Rajone të zhvilluara apo në zhvillim

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull “**Rajonet humane, tipat dhe rëndësia e tyre**” Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Rajone humane	Rajone fetare	Rajone të zhvilluara	Rajone në zhvillim
Disa rajone kanë qenë dhe vazhdojnë të kenë përqëndrim të popullsisë dhe disa të tjerë të jenë të zbrazët. Rajonet aziatike kanë ritme të larta të rritjes së popullsisë.	Rajonet fetare janë të ndryshme dhe të shpërndara në të gjithë kontinentin. Besimi i krishterë: Europë, Rusi, Amerikë. Besimi islam Afrikë veriore, Azi Jugperëndimore.	Vendet e zhvilluara quhen ndryshe rajoni qendror. Treguesit janë të ardhurat për frymë, jetëgjatësia, standarti i jetesës, ndikimi në mjedis etj.	Vendet në zhvillim quhen ndryshe rajoni periferi. Angola vend në zhvillim dhe të tjera.

Hapi III. Përfundimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Pse shpërndarja e popullsisë në tokë nuk është e njëtrajtshme?
2. Cilat janë familjet gjuhësore më të përhapura?
3. Cilat janë besimet fetare më të përhapura?
4. Cilët janë treguesit më të rëndësishëm të rajoneve të zhvilluara?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajone humane, rajone të zhvilluara, rajone në zhvillim

2. Vëreni grafikun 1 dhe 2 e formuloni përfundime për ç’ka ato përfaqësojnë.

3. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Formuloni përfundimet tuaja. Në cilin rajon futet Shqipëria për nga ana e zhvillimit ekonomik?



Bashkëveprimi dhe ndërvarësia midis rajoneve

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Bashkëveprimi dhe ndërvarësia midis rajoneve		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër dhe me Power Point. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për bashkëveprimin e Shqipërisë me vendet e Gadishullit të Ballkanit?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan fushat e bashkëveprimit rajonal; · Identifikon organizatat ndërkombëtare dhe rolin e tyre; · Shpjegon procesin e globalizimit, si dhe ndërvarësinë ekonomike, mjedisore dhe shoqërore; · Analizon ndikimin tek ai dhe të tjerët të programeve kompjuterike. 		Fjalët kyçe: bashkëveprimi, ndërvarësia, OKB, BE, Globalizim.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, interneti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, laptop, disk video-projektor, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetaria, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i detajuar/Diskutim	35'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	5'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Bashkëveprimi dhe ndërvarësia midis rajoneve**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër dhe me Power Point. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për bashkëveprimin e Shqipërisë me vendet e Gadishullit të Ballkanit? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 10– 11.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mëimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Bashkëveprimi rajonal dhe ndërkombëtar ndihmon zhvillimin

Të gjithë rajonet fizike dhe humane bashkëveprojnë në tregti, migrim, arsim, programe televizive dhe kompjuterike, si dhe nënshkruajnë marrëveshje politike, ekonomike, kulturore dhe mjedisore.

Organizata e Kombeve të Bashkuara e themeluar në 1945, Organizata Botërore e Natyrës e themeluar në 2010 me synimin kryesor mbrojtjen e mjedisit dhe të klimës në nivel ndërkombëtar.

2. Globalizimi dhe ndërvarësia midis rajoneve

Globalizimi është procesi i ndërveprimit dhe integritit ekonomik, shoqëror dhe politik dhe ka më shumë se një shekull që po zhvillohet. Ky proces i ka bërë njerëzit dhe rajonet e ndryshme të ndërvarur në dimension ekonomik, mjedisor dhe shoqëror. Programet kompjuterike rrisin më shumë ndërveprimin dhe ndërvarësinë shoqërore midis njerëzve.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: bashkëveprimi, ndërvarësia, globalizim, OKB dhe Bashkim Europian.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Në ç'mënyrë bashkëveprimi rajonal dhe ndërkombëtar ndihmon në zhvillimin e një vendi?
2. Cilat janë llojet e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare?
3. Cili është roli i organizatave rajonale dhe ndërkombëtare?
4. Në ç'mënyrë programet dhe aplikacionet kompjuterike rrisin ndërveprimin dhe ndërvarësinë tuaj me njerëzit e tjerë?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: bashkëveprimi, ndërvarësia, OKB, BE, Globalizim.

2. Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Shkruani një ese me temë "Mendo globalisht, vepra lokalisht". Si e kuptoni ju këtë? Diskutojini në klasë idetë tuaja.

Ese-në vendoseni në "Portofolin e të nxënësve me kompetenca", lënda Gjeografi 8.

**Veprimtari praktike: Rajonet e Botës****PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajonet e Botës		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Botës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonizimit?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shjeron rëndësinë e rajonizimit; · Plotëson hartën me emra të Rajoneve të Botës me emrat e rajoneve; · Përshkruan veçoritë e Rajoneve të Botës. 		Fjalët kyçe: rajon fizik, rajon human.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Rajoneve të Botës, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh**

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajonet e Botës**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën

e Botës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonizimit? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t’u ndjekur

1. Identifikoni rajonet
2. Plotësoni hartën me emrat e tyre
3. Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin rajon
4. Plotësoni hartën me nga një veçori kryesore të çdo rajoni

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon, rajon fizik, rajon human.
2. Cilat janë kriteret që përcaktojnë ndarjen në rajone fizike dhe humane?
3. Nga dallojnë rajonet fizike nga ato humane?

Nxënësit mbajnë shënime përgjigjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 7 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajonet e Botës”, në “Portofolin e të nxënësve me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Rajonet fiziko – gjeografike të Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Rajonet fiziko – gjeografike të Europës		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për relievin e Europës?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan llojet e ndryshme të relievit në kontinentin e Europës; · Përcakton në hartë rajonet fizike të Europës; · Analizon veçoritë e rajoneve fizike të Europës. 		Fjalët kyçe: fjord, rajone fizike, male të reja, male të vjetra.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5’
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/diskutim/ plotësim table	35’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	5’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajonet fiziko – gjeografike të Europës**

Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për relievin

e Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/diskutim/ plotësim tablele

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin me titull: **Rajonet fiziko – gjeografike të Europës**

Mësuesi shkruan në tabelë çështjet e mësimin.

1.Llojet e ndryshme të relievit në një kontinent të vogël

2. Veçoritë e rajoneve fizike të Europës

Për pjesën e parë të mësimin nxënësit diskutojnë me mësuesin për format e larmishme të relievit të kontinentit Europian.

Për pjesën e dytë të mësimin nxënësit udhëzohen që duke lexuar mësimin të plotësojnë tabelën.

Veçoritë e rajoneve fizike të Europës			
Vargu malor	Malet Qendrore	Malet Perëndimore	Fusha e Europës
Vargu malor alpin shrihet në formë harku rreth 1200 km i gjatë më i madhi në Europë. Alpet janë male të reja me 128 maja mbi 4000 m dhe maja më e lartë është Mon Blan	Malet Qendrore shrihen në qendër të Europës duke përfshirë disa malësi si: Masivi qendror dhe Voges në Francë, Ardenet në Belgjikë, Pylli i Zi dhe ai Tamunus në Gjermani dhe Ore dhe Sudetet në Çeki. Janë male të vjetra, jo shumë të larta dhe të pasura me pyje.	Malet Perëndimore nga Alpet e Skandinavisë në perëndim të Britanisë dhe deri në qendër të Spanjës. Janë male të vjetra, jo shumë të ulëta dhe të modeluara nga veprimtaria e akullnajave.	Fusha e Europës Veriore shrihet në lindje deri në malet Urale. Si rezultat i migrimit të vazhdueshëm të njerëzve është krijuar një mozaik kompleks dhe kulturor.

Mësuesi diskuton me nxënësit për veçoritë e rajoneve fizike të Europës, duke treguar dhe në hartë shtrirjen e secilit prej tyre. Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: fjord, rajone fizike, male të reja, male të vjetra.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1.Cilat janë format e ndryshme të relievit të kontinentit të Europës?

2. Cilat janë rajonet fizike në kontinentin e Europës.

3. Gjeneroni në hartë se ku shtrihen rajonet fizike të Europës.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 3 – 4 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimin punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1.Në rubrikën Mendoni në mënyrë kritike. Kërkoni informacion. Si ndikon relievi i vendbanimit tuaj në zhvillimin ekonomik e shoqëror të banorëve?

3. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Kërkoni informacion. Në cilin rajon fizik zhvillohet më shumë alpinizmi në Shqipëri? Pse?

Detyrën vendoseni në “Portofolin e të nxënësve me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Europa, pozita gjeografike, relievi

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Europa, pozita gjeografike, relievi		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën fizike të botës. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për pozitën gjeografike të një vendi?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përcakton në hartë shtrirjen gjeografike të kontinentit Europian; · Dallon pozitën gjeografike absolute nga pozita gjeografike relative; · Përshkruan klimën dhe hidrografinë e Europës. 		Fjalët kyçe: pozitë gjeografike absolute, pozitë gjeografike relative.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	35'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	5'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa, pozita gjeografike, relievi**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën fizike të Botës. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për pozitën gjeografike të një vendi? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Europa e vogël me privilegje të mëdha
2. Europa e pasur me mjedise natyrore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën "Di" shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën "Dua të di" shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën "Mësoj" shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
-Pozitë gjeografike absolute -Pozitë gjeografike relative - 4 njësitë e relievit të Europës dhe shtrirjen e tyre në hartë.	-Pse Europa quhet ndryshe "gadishulli i gadishujve"? -Pse në Europë gjenden shumëllojshmëri të mjediseve natyrore? - Cilat janë pasuritë minerale të Europës?	Sipërfaqen, pozitën dhe kufijtë e kontinentit të Europës. 4 rajonet klimatike të Europës. Lumenjtë dhe liqenet kryesor të Europës.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartën fizike shtrirjen e Europës, kufijtë, rajonet fizike, rajonet klimatike, lumenjtë dhe liqenet kryesor të Europës.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjalë ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: pozitë gjeografike absolute, pozitë gjeografike relative, shumëllojshmëri gjeologjike.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Pse Europa ka një pozitë gjeografike të favorshme?
2. Sa është sipërfaqja e Europës?
3. Pse në Europë gjenden shumëllojshmëri të mjediseve natyrore?
4. Cilat janë mjediset që e bëjnë Europën të pasur?
5. Si e kuptoni pohimin “Europa e vogël me privilegje të mëdha”?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 3 – 4 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Përcaktoni në hartën memece të Europës kufijtë e saj.
2. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Kërkoni të dhëna. Në cilën pjesë të Europës gjendet Shqipëria?



Klima e Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Klima e Europës		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 dhe 2 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për klimën e Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përcakton veçoritë klimatike të Europës; · Analizon veçoritë për secilën zonë klimatike; · Përcakton në hartë shtrirjen e secilës zonë klimatike; · Shpjegon ndryshimin e klimës në Europë nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim. 		Fjalët kyçe: klimë, klimë mesdhetare, klimë detare, klimë tranzitore, klimë kontinentale, klimë e akullt.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/diskutim/ plotësim tabele	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Klima e Europës**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit.. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 dhe 2 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për klimën e Europës? Disa nga përgjigjet e

nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/diskutim/ plotësim tablele

Mësuesi udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin me titull: **Klima e Europës**

Mësuesi shkruan në tabelë çështjet e mësimin.

1. Veçoritë kryesore klimatike të Europës
2. Nga Mesdheu diellor në Arktikun e akullt

Për pjesën e parë të mësimin nxënësit diskutojnë me mësuesin për veçoritë klimatike të kontinentit European.

Për pjesën e dytë të mësimin nxënësit udhëzohen që duke lexuar mësimin të plotësojnë tabelën.

Klima mesdhetare	Klima detare	Klima tranzitore	Klima kontinentale	Klima arktike
Brigjet jugore të Europës që lagen nga deti Mesdhe, kanë verë të nxehtë dhe dimër të butë	Përfshin brigjet perëndimore dhe veriperëndimore që janë nën ndikimin e rrymës së ngrohtë të gjirit të Meksikës. Reshje pothuajse gjatë gjithë vitit dhe verë të ngrohtë dhe të nxehtë në varësi të gjerësisë gjeografike dhe relievit	Në pjesën qendrore të kontinentit ndihet ndikimi i dyfishtë i masave ajrore detare dhe kontinentale. Dimri është i ftohtë me reshje dëbore në zonat e larta malore dhe verë të ngrohtë në zonat e ulëta.	Përfshin Europën lindore dhe një pjesë të Europës veriore. Dimri i gjatë dhe shumë i ftohtë, ndërsa vera e shkurtër dhe e freskët.	Pjesa më veriore e Europës shfaq shumëllojshmëri për nga sasia e diellit që merr gjatë vitit. Toka është në gjendje permafrost. Quhet dhe "Toka e Diellit të mesnatës".

Mësuesi diskuton me nxënësit për veçoritë klimatike të Europës. Mësuesi tregon dhe në hartë shtrirjen e secilës zone klimatike. Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: klimë, klimë mesdhetare, klimë detare, klimë tranzitore, klimë kontinentale, klimë e akullt.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë kryesore klimatike të Europës?
2. Në ç'mënyrë ndikon klima në zhvillimin ekonomik të vendit?
3. Si ndryshon klima e Europës nga jugu në veri dhe nga lindja në perëndim?
4. Përcaktoni në hartë shtrirjen e secilës zone klimatike dhe shtetet që ndodhen në çdo zonë?
5. Në cilën pjesë të Europës ndodh që në disa ditë dimri dielli nuk lind kurrë dhe në disa ditë vere nuk perëndon kurrë?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimin punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën Mendoni në mënyrë kritike. Kërkoni informacion për termin permafrost.
3. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Kërkoni informacion. Në cilin rajon klimatik të Europës bën pjesë Shqipëria?



Pasuritë ujore të Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Pasuritë ujore të Europës		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 dhe 2 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për pasuritë ujore të Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë e lumenjve të Europës; · Identifikon në hartë lumenjtë e Europës; · Përcakton në hartë shtrirjen e deteve dhe liqeneve të Europës. 		Fjalët kyçe: lumi Danub, deti Kaspik	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: : Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i përparuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Pasuritë ujore të Europës**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 dhe 2 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për pasuritë ujore të Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 19– 20.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Lumenjtë e Europës dhe rëndësia e tyre

Reni dhe Danubi janë dy lumenjtë kryesor në Europës. Regjimi i prurjeve varet nga: sasia e e reshjeve; shkrirja e borës, dhe poroziteti i shkëmbinjve. Sipas regjimit lumenjtë kanë prurje të ndryshme. Ata që ushqehen nga dëborat prurjet më të mëdha i kanë në pranverë dhe verë si lumi Vollga, ndërsa me ushqim nga reshjet e shiut kanë prurje të larta gjatë dimrit.

Lumenjtë sipas drejtimit i ndajmë në veriorë (që derdhen në oqeanin Atlantik dhe detet veriorë) dhe jugorë (që derdhen në detin Mesdhe, detin e Zi, Kaspik).

2. Europa e deteve dhe e liqeneve

Europa laget në veri Oqeani Akrtik (i Ngrirë i Veriut), në perëndim dhe veriperëndim nga oqeani Atlantik dhe në jug nga deti Mesdhe.

Liqene akullnajorë në Alpe, Skandinavi. Në Finlnadë 1/5 e territorit. Liqene vullkanike në Italinë qendrore, si dhe përgjarë brigjeve detare liqene të vegjël dhe laguna bregdetare. Deti Kaspik liqeni më i madh në botë për nga sipërfaqja, si dhe tjerë janë: Ladoga, Onega, Venern etj.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: lumi Danub, deti Kaspik.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Nga se varet regjimi i prurjeve dhe niveli i lumenjve të Europës?
2. Cila është karakteristika kryesore që dallon lumenjtë veriorë nga ata jugorë?
3. Cilët janë detet dhe oqeanet që lagin kontinentin e Europës?
4. Cilët janë lumenjtë dhe liqenet kryesorë të Europës?
5. Pse emërtohet deti Kaspik kur në fakt është liqen?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: lumi Danub, deti Kaspik, poroziteti i shkëmbinjve.

2. Në rubrikën lokalizoni. Identifikoni shtetet kontinentale, pa asnjë dalje në det. Shpjegoni, si ndikon kjo gjë në zhvillimin e tyre?

3. Në rubrikën kërkoni informacion. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Cili është regjimi i lumenjve gjatë stinës së verës në Shqipëri?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Europa, pozita gjeografike, karakteristikat e mjedisit natyror		Situata e të nxënët: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e pozitës gjeografike të Europës?	
Rezultatet e të nxënët: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon rëndësinë e pozitës gjeografike të Europës; · Plotëson hartën e Europës me emrat e oqeanëve, deteve, gjireve, ishujve dhe gadishujve që i përkasin Europës; · Plotëson hartën e Europës me emrat e lumenjve, liqeneve, malet, fushat që i përkasin mjedisit natyror të Europës; 		Fjalët kyçe: pozitë gjeografike, mjedis natyror.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e fizike e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Europa, pozita gjeografike, karakteristikat e mjedisit natyror**

Mësuesi përdor situatën e të nxënët në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e pozitës gjeografike të Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Identifikoni paralelet dhe meridianët që përkufizojnë Europën
2. Plotësoni hartën e Europës me emrat e oqeanëve, deteve, gjireve, ishujve dhe gadishujve që i përkasin Europës;
3. Plotësoni hartën e Europës me emrat e lumenjve, liqeneve, malet, fushat që i përkasin mjedisit natyror të Europës;
4. Ngjyrosni me ngjyrën përkatëse secilin element fiziko-gjeografik.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: pozitë gjeografike, mjedis natyror.
2. Pse në Europë gjenden shumë llojshmëri të mjedisve natyrore?

Nxënësit mbajnë shënime përgjigjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5-6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “fizike të Europës”, në “Portofolin e të nxënësve me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.

**Bimësia dhe bota e gjallë në Europë****PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Bimësia dhe bota e gjallë në Europë		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të shohin me video-projektor në Power Point foto të bimësisë mesdhetare dhe kafshë të ndryshme. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për florën dhe faunën e Europës?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan tiparet e bimësisë në Europë; · Analizon zonat më të mëdha bimë dhe shtazore në Europë duke u nisur nga jugu drejt veriut; · Argumenton zëvendësimin e bimësisë natyrore me kultura bujqësore. 		Fjalët kyçe: makia mesdhetare, zona e tundrës, zona e tajgës, zona e Europës Atlantike.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/Harta e të pyeturit	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë	10'

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh**

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Bimësia dhe bota e gjallë në Europë**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të shohin me video-projektor në Power Point foto të bimësisë mesdhetare dhe kafshë të ndryshme. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për florën dhe faunën e Europës?

Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Harta e të pyeturit

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mëimit, si më poshtë;


1. Tiparet kryesore të bimësisë së Europës
2. Zonat më të mëdha bimore e shtazore në Europë

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull “**Bimësia dhe bota e gjallë në Europë**”

Gjatë leximit të mëimit nxënësit plotësojnë në fletore përgjigjet e pyetjeve në hartën e të pyeturit **HARTA E TË PYETURIT**



Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo përgjigjeje, mësuesja u përgjigjet pyetjeve që nxënësit kanë për njohuritë që janë të reja për ta, duke diskutuar për përgjigjet e sakta të tyre.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen dhe formulohen dhe njëherë fjalët kyçe: makia mesdhetare, zona e tundrës, zona e tajgës, zona e Europës Atlantike.

Hapi III. Përforsimi: Shkrim i lirë

Mësuesi shkruan në tabelë temën e shkrimit të lirë;

Ese argumentuese:

Tema: Shkaqet e zëvendësimit të bimësisë natyrore me bimësi të kultivuar në Europë.

Lexohet detyra nga 4 – 5 nxënës.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mëimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën fjalë kyç: Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: makia mesdhetare, zona e tundrës, zona e tajgës, zona e Europës Atlantike.



Marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të shohin me video-projektor në Power Point foto të librit dhe të tjera të Holandës, Venecias, Eurotunelit etj.. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për territorin e Holandës dhe Venecias?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan marrëdhënien njeri-mjedis; · Shpjegon arsyet e ngritjes së digave në Holandë; · Përcakton në hartë Eurotunelin dhe tunelin Gothard; · Analizon pasojat që sjell marrëdhënia problematike njeri – mjedis. 		Fjalët kyçe: njeri-mjedis	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetaria, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i përparuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të shohin me video-projektor në Power Point foto të librit dhe të tjera të Holandës, Venecias, Eurotunelit etj.. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për territorin e Holandës dhe Venecias?

Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 24 – 25.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Europa me mjedis të transformuar

Zhvillimi i teknologjisë i dha mundësinë njeriut të transformojë dhe krijojë peizazhe të reja në natyrë. Më të rëndësishmet janë:

Tokat e fituara nga deti në Holandë.

Qyteti i Venecias & Eurotuneli

Hapja e tuneleve përmes maleve të lartë për lehtësimin e lëvizjes.

2. Njeri – mjedis, një marrëdhënie problematike në Europë

Marrëdhënia njeri – mjedis mbetet shumë delikate dhe problematike.

Ndërgjegjësimi për mbrotjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm është tema e ditës jo vetëm për vendet e BE-së, por edhe për ato që duan të bëhen pjesë e tij.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Pas përfundimit të plotësimit mësuesja u përgjigjet pyetjeve që nxënësit kanë për njohuritë që janë të reja për ta, duke diskutuar për përgjigjet e sakta të tyre.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen dhe formulohen dhe njëherë fjalët kyçe: njeri-mjedis
Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Problemet mjedisore që shkakton veprimtaria e njeriut,

Grupi 2. Mënyra e përballimit të problemeve mjedisore

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Cilat janë problemet mjedisore në vendbanimin tuaj? Cili është propozimi juaj për t'i zgjidhur ato?



Veprimtari praktike: Eurotuneli Gothard në Alpet e Zvicrës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Eurotuneli Gothard në Alpet e Zvicrës		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Çfarë dini për tunelet e Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon rëndësinë e tuneleve në Alpet e Europës; · Përcakton në hartë emrat e vendeve që kalohet nga Zyrihu në Milano; · Analizon informacionin që mori për Eurotunelin Gothard duke theksuar dhe rëndësinë e tij; 		Fjalët kyçe: Eurotunel	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e fizike e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra, laptop, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/Vëzhgim i detajuar/Punë e pavarur	25'
Hapi III. Përforcimi	Lexim/Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Eurotuneli Gothard në Alpet e Zvicrës**
Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën e Europës. Çfarë dini për tunelet e Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Vëzhgim i detajuar/Punë e pavarur

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Gjeni vendndodhjen e Eurotunnelit në hartë.
2. Lexoni informacionin që keni në libër.
3. Shkruani një informacion të shkurtër, duke shpjeguar se çfarë informacioni morët nga harta.
4. Shkruani udhëtimin tuaj imagjinar duke u nisur nga Zyrihu deri në Milano. Përmendni emrat e stacioneve që kaloni.
5. Shkruani një paragraf, çfarë ndjetë kur kaluat në Eurotunnel?

Hapi III. Përforcimi: Lexim/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Lexohet detyra nga 5 – 6 nxënës. Nxënësit mbajnë shënime dhe më pas diskutohet me mësuesin për pyetjet, përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Bazuar, nga çfarë mësuar dhe punuar në klasë shkruani ese-në “Unë kam një ëndërr..”

Dokumentimi

Vendoseni, ese-në, në “Portofolin e të nxënësit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës Ora e parë e projektit, me temë: përzgjedhja e temës së projektit		Situata e të nxënës: Nxënësit e dinë se ç'është projekti. Zgjidhni një temë nga ato që vetë do propozoni dhe organizohuni për të punuar.	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Argumenton zgjedhjen e bërë; · Shpreh dëshirën për të bashkëpunuar; · Mëson strukturën e një projekti; · Fiton shprehje për t'u organizuar. 		Fjalët kyç: Projekt kurrikular, rezultate të nxënës gjatë projektit, burime informacioni, grup pune, mjedis pune, vende të industrializuara, G 8.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, Interneti, Literaturë gjeografike.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim i lirë	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Zgjidhje problemesh/ Punë me gjithë klasën	30'
Hapi III. Përforcimi	Diskutim/ Punë në grupe	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim i lirë

Mësuesi u rikujton nxënësve se çfarë është projekti.

Në vijim fton nxënësit të propozojnë disa tema, por dhe vetë mësuesi propozon tema për projektin.

Pasi mbaron procesi i propozimeve, me shumicë votash nxënësit vendosin për një të njërën nga temat.

Më pas kalohet në organizimin e nxënësve për të punuar.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Zgjidhje problemesh/ Punë me gjithë klasën

Mësuesi udhëzon nxënësit për mënyrën e punimit të projektit, ku ata mund të punojnë individualisht, ose maksimumi në grupe nga 3 – 4 nxënës. Kjo për arsye se vlerësimi i projektit do të përfshihet te

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

vlërësimi përmbledhës dhe duhet të jetë sa më objektiv. Mësuesi orienton nxënësit për strukturën e projektit, burimet, mjediset e punës, formën e produktit, natyrën dhe kriteret e vlerësimit, etj.

Struktura e projektit për nxënësit:

1. Tema e projektit
2. Tema e miniprojektit për grup/nxënës
3. Qëllimi i projektit
4. Rezultatet e të nxënit të projektit
5. Lëndët/ fushat/ temat ndërkurrikulare të përfshira
6. Përmbajtja e projektit
7. Raporti përfundimtar
8. Përfundime/ rekomandime
9. Burimet/ bibliografia/ referencat

Hapi III. Përforcimi: Diskutim/ Punë në grupe

Pas grafikut të hartuar, nxënësit ndahen në grupe sipas prirjeve vetjake.

- Zgjidhet liderin e grupit;
- Ndahen detyrat për secilin nga anëtarët;
- Nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit lidhur me projektin, duke diskutuar dhe me shokët e grupit.

Vlerësimi: Vlerësim me gojë, individual për argumentat e përzgjedhjes së temës.

Detyra dhe punë e pavarur

Saktësimi i temës së miniprojektit, gjetja e informacioneve që lidhen me temën e projektit deri në fazën pasardhëse.



Popullsia e Europës dhe zhvillimi i saj

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Popullsia e Europës dhe zhvillimi i saj		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon uljen e ritmit të shtimit të popullsisë; · Analizon dukurinë e plakjes së popullsisë në Europën Perëndimore; · Shpjegon familjet kryesore të gjuhëve në Europë. 		Fjalët kyçe: urbanizim, dendësi e popullsisë	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetaria, TIK-u, Matematika.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i përparuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Popullsia e Europës dhe zhvillimi i saj**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun

1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Europës?

Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 30– 31.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Europa po shkon drejt "plakjes"

Shtimi natyror i popullsisë po ulet, madje në disa vende ritmi është negativ. Duke filluar nga mesi i shek. XX, shkalla e lartë e urbanizimit të Europës ndikoi në uljen e ritmeve të rritjes së popullsisë dhe dendësisë së saj. Problemi i plakjes së popullsisë është shfaqur më herët në vendet e Europës Perëndimore, por tani po prek edhe vendet në zhvillim.

2. Bsshkëjetesa e kulturave europiane, gjuhëve dhe feve të ndryshme

Kontakti i kulturave si rezultat i ardhjes së shumë imigrantëve, si dhe po ndryshon përbërja sociale e shteteve të ndryshme. Gjuhët janë në grupin Indo-European dhe ndahen në latine, gjermanike dhe sllavike. 76.2 % janë të krishterë dhe rreth 6 % islam më pak judaizmi, hinduizmi, budizmi etj., ndërsa 18.8 % janë deklaruar ateist.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Pas përfundimit të plotësimit mësuesja u përgjigjet pyetjeve që nxënësit kanë për njohuritë që janë të reja për ta, duke diskutuar për përgjigjet e sakta të tyre.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen dhe formulohen dhe njëherë fjalët kyçe: urbanizim, dendësi e popullsisë.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secilin grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Europa kontinenti "plak"

Grupi 2. Europa Perëndimore ka nevojë për fuqi punëtore

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Lidheni me gjeografinë e Shqipërisë. Sipas hartës nr.2, po Shqipëria si i ka ritmet e shtimit të popullsisë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit? Pse?



Tipare të përgjithshme të zhvillimit urban në Europë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Tipare të përgjithshme të zhvillimit urban në Europë		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 dhe 2 , si dhe fotot 1,2,3 dhe 4 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për qytetet kryesore të Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja:		Fjalët kyçe: qendër urbane, qendra të mëdha metropolitane, "smart city".	
<ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan zhvillimin e qendrave urbane në Europë; · Analizon rritjen e popullsisë urbane; · Shpjegon tendencat dhe problemet aktuale të urbanizimit në Europë. 			
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Matematika, Qytetaria, TIK-u	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Tipare të përgjithshme të zhvillimit urban në Europë**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 dhe 2, si dhe fotot 1,2,3 dhe 4 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për qytetet kryesore të Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Urbanizimi i Europës

2. Tendencat dhe problemet aktuale të urbanizimit në Europë

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Zhvillimin e qyteteve në periudhën e Mesjetës. Venecia qendër e prodhimit të qelqit, anijeve dhe Firenze qendër arti, arsimimi. Qytetet më të mëdha të Europës. Disa qytete janë kthyer në qendra të mëdha metropolitane.	-Si u rrit popullsia e qyteteve në Europë? -Si janë organizuar zonat metropolitane? -Cilat janë problemet me të cilat përballen qytetet kryesore të Europës? - Ç’është modeli “smart city”?	Në 1801 17 % e popullsisë jetonte në qytete, në 1851 arriti 35 % dhe në 1891 ishte 54 %, ndërsa sot 73 %. Rritja e numrit të popullsisë ka sjellë rritje të kriminalitetit, papunësisë, krijimin e lagjeve të varfra në periferi.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartën 1 qytetet më të mëdha në botë dhe shpjegojmë çfarë përfaqësonjë fotot 1,2,3 dhe 4.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjalë ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: qendër urbane, qendra të mëdha metropolitane, “smart city”.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë tiparet e qendrave urbane?
2. Cilat janë tendencat aktuale të urbanizimit në Europë?
3. Cilat janë problemet aktuale të urbanizimit në Europë?
4. Çfarë masash përdor BE për minimizimin e problemeve urbane?
5. Si ndryshon popullsia urbane nga Lindja në Perëndim të Europës?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Çfarë masash përdor bashkia ku ju jetoni për minimizimin e problemeve urbane?



Tipare të përgjithshme të zhvillimit urban në Europë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Planifikimi urban		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë fotot që kanë në libër. Parisi qyteti i parë në botë me planifikim urban.	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon kuptimin e termit planifikim urban; · Vlerëson rëndësinë e planifikimit urbanistik; · Evidenton qëllimet kryesore të projektimit urban të qëndrueshëm; 		Fjalët kyçe: planifikim urban	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, hartë urbanistike, vizore, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	20'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim	20'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Planifikimi urban**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë fotot që kanë në libër. Parisi qyteti i parë në botë me planifikim urban. Më pas diskutojnë mësues nxënës për mënyrën e vendosjes së ndërtesave në Paris, Tiranë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Nxënësit lexojnë tekstin mësimor Gjeografi 8 në fq. 34

Gjatë leximit mbajnë shënimet duhura për planifikimin urban, si dhe më pas diskutojmë së bashku pse duhet planifikimi urban.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është vizatuar nga nxënësit plani urban i një lagjeje, ose qendrës së vendbanimit të tyre. mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: planifikim urban.
2. Si është bërë rinovimi urban i qytetit?
3. Çfarë plani zhvillimi të ri ka qyteti?

Nxënësit mbajnë shënime përgjigjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për .

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5-6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, planin që keni vizatuar, në "Portofolin e të nxënësve me kompetenca", lënda Gjeografi 8.



Tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të hapësirës europiane

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të hapësirës europiane		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1,2,3 dhe 4 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për zhvillimin ekonomik të Europës?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan ecurinë e zhvillimit ekonomik të vendeve të Europës; · Përcakton vendet që u ndihmuan nga Plani Marshall; · Analizon rajonet më të industrializuara në Europë; · Shpjegon aktivitetet e ekonomisë europiane, si dhe katër motorët e Europës. 		Fjalët kyçe: Plani Marshall, ekonomi, Katër motorët e Europës.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i përparuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforsimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Tipare të përgjithshme të zhvillimit ekonomik të hapësirës europiane**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1,2,3 dhe 4 me Power Point në kompjuter. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për zhvillimin ekonomik të Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 36– 37.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Zhvillimi ekonomik i Europës

Europa konsiderohet si rajoni më i pasur, ku vendet perëndimore mbeten në krye të zhvillimit. Vendet e Europës morën ndihmën nga Plani Marshall pas L II B. Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore vendosën regjimin komunist dhe ekonominë e centralizuar. Pas vitit 1990 në këto vende u vendos ekonomia e tregut.

2. Aktivitetet kryesore ekonomike të Europës

Europa ka burime të shumta natyrore dhe humane që kanë mbështetur ekonominë e saj. Brezi i qymyrgurit, rajoni i Ruhrit, Alsas-Lorena, rezervat e naftës dhe të gazit kanë mundësuar zhvillimin industrial të Europës.

Ekonomia bujqësore favorizohet nga tokat pjellore. Pasuritë ujore mbështesin zhvillimin e peshkimit, turizmit. Aktivitete të tjera janë: industria e ndërtimit të automobilave, industria ushqimore, tekstile, e modës etj. Katër motorët e Europës janë: Rajoni Juglindor i Francës me qendër Lion; Italia Veriore me

qendër Milano; Spanja Verilindore me qendër Barcelonën; dhe Gjermania Jugperëndimore me qendër Shtutgart.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin dhe diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Pas përfundimit të plotësimit mësuesja u përgjigjet pyetjeve që nxënësit kanë për njohuritë që janë të reja për ta, duke diskutuar për përgjigjet e sakta të tyre.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen dhe formulohen dhe njëherë fjalët kyçe: Plani Marshall, ekonomi, Katër motorët e Europës.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

1. Cilat janë faktet dhe të dhënat që dëshmojnë larminë e zhvillimit ekonomik të hapësirës europiane?
2. Cilat janë shkaqet e zhvillimit të pabarabartë të vendeve europiane?
3. Cilat janë rajonet më të industrializuara në Europë?
4. Cilat janë aktivitetet e rëndësishme të ekonomisë Europiane?
5. Përcaktoni në hartë vendet që pranuan Planin Marshall, brezin e rezervave të qymyrgurit, qendrat kryesore të zhvillimit urban.
6. Cili shtet i Europës zë vendin e parë në prodhimin e çelikut?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. A bën pjesë Shqipëria në ndonjë rajon ekonomik europian? Pse?



Rajonet kryesore të Europës, veçoritë fizike dhe humane të tyre

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Rajonet kryesore të Europës, veçoritë fizike dhe humane të tyre		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet e Europës?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përcakton në hartë shtrirjen e rajoneve të Europës; · Përshkruan veçoritë fiziko-gjeografike të tyre; · Shpjegon veçoritë humane të rajoneve të Europës. 		Fjalët kyçe: Prodhimi i përgjithshëm bruto.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajonet kryesore të Europës, veçoritë fizike dhe humane të tyre**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit.. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë grafikun 1 në libër dhe hartën 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonet e Europës? Disa nga

përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Rajonet e Europës dhe veçoritë fiziko-gjeografike të tyre

2. Veçoritë humane të rajoneve të Europës

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
-Pozitë gjeografike të favorshme, relief të larmishëm, tipe të ndryshme klimash, vijë të gjatë bregdetare etj. Rajonet e Europës dallohen nga besimi fetar dhe nga gjuhët që fliten.	-Cilat janë veçoritë fiziko-gjeografike për secilin rajon? -Cilat janë veçoritë e secilit rajon ekonomik? -Si do të ndikojë zgjerimi i BE-së, për ndarjen rajonale të Europës në të ardhmen?	Europa ndahet në 4 rajone kryesore: Europa Perëndimore, Lindore, Veriore, Lindore dhe Mesdhetare. Rajoni Qendror ka nivel të lartë të zhvillimit ekonomik e shoqëror, qendrat më të mëdha urbane etj. Rajoni periferik përfshin shumicën e vendeve që dolën nga regjimi komunist, që shfaqin probleme të shumta ekonomike, politike, si dhe të emigrimit.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë shtrirjen e rajoneve të Europës dhe veçoritë fiziko-gjeografike të tyre.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Prodhimi i përgjithshëm bruto

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë që përcaktojnë ndarjen e Europës në katër rajone?
2. Cilat janë dallimet midis rajoneve?
3. Cilat janë veçoritë humane të rajoneve të Europës?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. 1. Vëreni foton e formuloni përfundime për ç’ka ajo përfaqëson.

2. Qëndrimi juaj. Politika e Bashkimit European është në mbështetje të ruajtjes dhe zhvillimit të gjuhëve. Pse?



Veprimtari praktike: Rajonet e Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajonet e Europës		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajoneve të Europës?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shjegovon rëndësinë e rajonizimit; · Plotëson hartën me emra të Rajoneve të Europës me emrat e rajoneve; · Përshkruan veçoritë e Rajoneve të Europës. 		Fjalët kyçe: rajon, rajon fizik, rajon human.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësja, harta e Rajoneve të Europës, stilolaps, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforsimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajonet e Europës**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajoneve të Europës? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për rajonet e Europës.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Identifikoni rajonet
2. Plotësoni hartën me emrat e tyre
3. Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin rajon
4. Plotësoni hartën me nga një veçori kryesore të çdo rajoni

Hapi III. Përforsimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon, rajon fizik, rajon human.
2. Cilat janë kriteret që përcaktojnë ndarjen në rajone fizike dhe humane?
3. Nga dallojnë rajonet e Europës nga njëri – tjetri?

Nxënësit mbajnë shënime përgjigjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajonet e Europës”, në “Portofolin e të nxënësve me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Veprimtari praktike: Plotësimi i hartës memece: Gjuhët dhe besimet fetare në Europë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Plotësimi i hartës memece: Gjuhët dhe besimet fetare në Europë		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cilët gjuhë dhe besime fetare janë më të përhapura në Europë?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shjegovon rëndësinë e gjuhëve dhe besimeve fetare që janë në Europë; Plotëson hartën memece të Europës me emrat e gjuhëve e kombet i përdorin në Europë dhe besimet e tyre; Përshkruan veçoritë e gjuhëve dhe besimeve fetare. 		Fjalët kyçe: Europë, gjuhë, besim.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, harta e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/Plotësim harte	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Plotësimi i hartës memece: Gjuhët dhe besimet fetare në Europë**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cilët gjuhë dhe besime fetare janë më të përhapura në Europë? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për përdorimin më shumë të dy gjuhëve në Europë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Plotësim harte

Hapa për t'u ndjekur

1. Lexoni informacionin në libër për gjuhët dhe besimet fetare.
2. Plotësoni hartën e gjuhëve me emrat e gjuhëve që flet secili vend europian.
3. Plotësoni hartën e besimeve me emrat e besimeve që ndjek secili vend europian.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Europë, gjuhë, besim.
2. Në ç'mënyrë gjuhët dhe besimet në Europë ndihmojnë ose pengojnë integrimin europian?

Nxënësit mbajnë shënime përgjigjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajonet e Europës”, në “Portofolin e të nxënimit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Europa Perëndimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Europa Perëndimore		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1, 2 dhe 3 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Perëndimore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përkthejnë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Perëndimore; · Dallon tiparet e popullsisë së rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të shteteve të rajonit. 		Fjalët kyçe: peizazhi kulturor, peizazhi arkitekturor.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Biologjia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/plotësim tabela	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa Perëndimore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1, 2 dhe 3 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Perëndimore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Plotësim tabelle

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të rajonit të Europës Perëndimore
2. Tiparet e popullsisë dhe ekonomisë së rajonit

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull "**Europa Perëndimore**" Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore			
Shtetet	Relievi	Hidrografia	Klima
Francë, Gjermani, Belgjikë, Holandë, Luksenburg, Zvicër, Austri dhe Litenshtejn	Lartësitë Alpine, Masivi Qendror Francez dhe fushat e perëndimit.	Lumenj: Reni, Danubi, Sena, Elba, Garona, etj. Liqene: Gjenevës, Kostancës.	Klima atlatike, alpine dhe mesdhetare.
Popullsia dhe ekonomia e rajonit		Ekonomia	
Popullsia		Ekonomia	

Gjermani numrin më të lartë të popullsisë, ndërsa Holanda dendësinë më të madhe. Në rajon ka fluks emigrantësh që ndikon në përzierjen e kulturës, gjuhës dhe feve të tij. Gjuhë gjermanike dhe romane, ndërsa besimi i krishterë katolik, portestant dhe shumë pak mysliman.	Gjermania dhe Franca prodhojnë avionë automobila, trena, tekstile, prodhime farmaceutike, armatime, pajisje mekanike etj. Dhe vendet e tjera kanë nivel të lartë zhvillimi ekonomik. Sektori i shërbimeve është shumë i zhvilluar në rajon. Turizmi alpin është i zhvilluar në shtetet alpine.
---	--

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Perëndimore?
2. Çfarë tiparësh ka popullsia e rajonit?
3. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të tij?
4. Tregoni në hartë rajonin, burimet ujore, shtetet dhe qytetet kryesore të tij.
5. Si ndikojnë përzierja e gjuhëve, feve dhe kulturave në rajonin e Europës Perëndimore?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në vendet e rajonit perëndimor. Pyeteni, si ndihet ai/ajo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Veprimtari praktike: Gjermania, model i zhvillimit në Rajonin e Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Gjermania, model i zhvillimit në Rajonin e Europës		Situata e të nxënit: Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Gjermania	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Analizon ecurinë e zhvillimit ekonomik të Gjermanisë; · Përcakton zonat më të zhvilluara industriale të Gjermanisë; · Argumenton se Gjermania është një nga vendet me eksporte të larta në Europë. 		Fjalët kyçe: Gjermania, ekonomi tregu	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Gjermanisë, stilolasp, lapsa. Laptop, video-projektor, disk.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Lexim i shpejtë/ Diskutim	7'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Ese	30'
Hapi III. Përforcimi	Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	8'

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Parashikimi: Lexim i shpejtë/ Diskutim**

Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Gjermania

Në vijim mësuesi fton nxënësit të lexojnë shpejt me zë të lartë, materialin në tekst në faqen 45-46 me titull “Gjermania, modeli i zhvillimit në Rajonin e Europës”

Më pas kalohet në diskutim të lirë nga nxënësit duke analizuar informacionin që dëgjuan.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Ese

Mësuesi e ndan klasën në dy grupe dhe për secilin grup shkruan në tabelë temën e ese-së që do të zhvillojnë në klasë.

Ese argumentuese. Tema: Gjermania, modeli i zhvillimit në Rajonin e Europës

Hapi III. Përforcimi: Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

1. 5 -6 Nxënës do të lexojnë esen që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

2. Cili është mesazhi i ese-së për ju?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni ese-në, në “Portofolin e të nxënësit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.

**Europa Veriore****PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Europa Veriore		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1, 2 dhe 3 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Veriore?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë natyrore të rajonit të Europës Veriore; · Dallon tiparet e popullsisë së rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të shteteve të rajonit. 		Fjalët kyçe: rajon i Europës Veriore, fjord, toka e zjarrit, gadishulli Skandinav.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Biologjia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar/plotësim tabele	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Stuhi mendimesh**

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa Veriore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1, 2 dhe 3 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Veriore? Disa nga përgjigjet

e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/Plotësim tabelle

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të rajonit të Europës Veriore
2. Popullsia dhe ekonomia e Europës Veriore

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Europa Veriore”**. Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore			
Shtetet	Relievi	Hidrografia dhe bimësia	Klima
Finlandë, Suedi, Norvegji, Danimarka, Islandë dhe Estoni.	Malet e Skandinavisë, fjordet në Norvegji, vullkane që quhen dhe toka e zjarrit	Lumi Gloma etj. Rreth 60.000 liqene në Finlandë. Bimësia tipike e tajgës, tundra më në jug. Finlanda me 76 % pyje dhe Islanda pa pemë.	Klima do të ishte dhe më e ftohtë nëse nuk do të ishte nën ndikimin e rrymës së Gjirit.
Popullsia dhe ekonomia e rajonit			
Popullsia		Ekonomia	
Është më pak e populluar se rajonet e tjera. Suedia ka numrin më të madh të popullsisë dhe Islanda më pak e populluar. Norvegjishtja, suedishtja dhe danishtja janë gjuhë gjermanike, ndërsa finlandishtja dhe estonishtja në grupin e gjuhëve uralike. Besimi fetar kryesor është protestant dhe shumë pak mysliman. Në qytet jeton 80 % e popullsisë, standart të lartë jetese, respektim të të drejtave të njeriut.		Vendet e rajonit kanë shfrytëzuar burimet e tyre për të zhvilluar ekonominë. Suedia prodhon automobila, pajisje elektronike, çelik etj., Finlanda prodhuese kryesore e lëndës drusore dhe prodhuesja e parë e telefonave Nokia. Norvegjia ka rezerva naftë në detin e Veriut. Islanda dallohet për peshkimin dhe përpunimin e saj, si dhe zhvillimin e turizmit.. Danimarka vendi më pak i korruptuar në botë, ndërsa Estonia po zhvillohet ekonomikisht për të arritur vendet e rajonit.	

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Veriore?
2. Çfarë tiparësh ka popullsia e rajonit?
3. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të tij?
4. Tregoni në hartë rajonin, burimet ujore, shtetet dhe qytetet kryesore të tij.
5. Gjenerali në hartë burimet ujore dhe qytetet kryesore të rajonit.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Finlanda është prodhuesja e parë e telefonave Nokia. Formuloni gjykimin tuaj mbi zhvillimin teknologjik të Finlandës.

2. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjenerali ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në vendet e rajonit verior. Pyeteni, si ndihet ai/a jo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Përsëritje në nëntematikat: I. Rajonet dhe rajonizimi dhe II. Europa

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Përsëritje në nëntematikat: I. Rajonet dhe rajonizimi dhe II. Europa		Situata e të nxënit: Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor hartën e të pyeturit. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon pse gjeografët krijojnë dhe përdorin rajonet si koncepte organizuese; · Identifikon tipet kryesore të rajoneve në botë; · Lokalizon në hartë dhe interpreton rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë; · Identifikon ngjashmëritë dhe dallimet në veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajoneve të Europës; · Përshkruan veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Europës Perëndimore dhe Veriore. 		Fjalët kyç: rajoni, rajonizimi, rajon malor, rajon fushor, rajon klimatik, rajon bimor, rajone humane, rajone të zhvilluara, rajone në zhvillim, bashkëveprimi, ndërvarësia, OKB, BE, Globalizim, fjord, rajone fizike, male të reja, male të vjetra, pozitë gjeografike absolute, pozitë gjeografike relative, klimë, klimë mesdhetare, klimë detare, klimë tranzitore, klimë kontinentale, klimë e akullt, lumi Danub, deti Kaspik, makia mesdhetare, zona e tundrës, zona e tajgës, zona e Europës Atlantike, njeri-mjedis, urbanizim, dendësi e popullsisë, qendër urbane, qendra Plani Marshall, ekonomi, Katër motorët e Europës. "smart city".	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, harta mësimore, dërrasa e zezë, shkumësa, laptop, video-projektor, disk flipçart, fleta formati, lasp.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Harta e të pyeturit	10'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim tabele/punë në grupe	25'
Hapi III. Përforsimi	Diagrama e Venit	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Harta e të pyeturit

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Përsëritje në nëntematikat: I. Rajonet dhe rajonizimi dhe II. Europa**

Ora e mësimit fillon me prezantimin e çështjeve për diskutim, të sugjeruara nga nxënësit, sepse orën që vjen më pas do të zhvillohet provim dhe nxënësit parashatrojnë ato çështje të cilat duan dhe shpjegime.

Në vijim mësuesi shpjegon paqartësitë që kanë nxënësit.

Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor hartën e të pyeturit. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë. Nxënësit hartën e të pyeturit e kanë dhe në libër. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim tabele/punë në grupe

1. Nxënësit ndërtojnë në fletore tabelën që kanë në libër dhe e plotësojnë.

Plotësoni tabelën:

Kontinenti i Europës				
Relievi	Klima	Hidrografia	Bimësia	Bota e gjallë

2. Mësuesi e ndan klasën në 6 grupe dhe secili grup do të shkruajë nga një fjali ku të shpjegojë kuptimin e fjalës.

Grupi 1. Rajoni, rajon klimatik, BE, pozitë gjeografike absolute, pozitë gjeografike relative, zona e tajgës, zona e Europës Atlantike, peizazhi arkitekturor.

Grupi 2. Rajonizimi, rajon bimor, Globalizim, klimë, klimë mesdhetare, njeri-mjedis, urbanizim, peizazhi arkitekturor, gadishulli Skandinav.

Grupi 3. Rajon malor, rajone humane, fjord, klimë detare, klimë tranzitore, dendësi e popullsisë, qendër urbane, rajon i Europës Veriore.


Grupi 4. Rajon fushor, bashkëveprimi, rajone fizike, klimë kontinentale, klimë e akullt, qendra Plani Marshall, ekonomi, peizazhi arkitekturor.

Grupi 5. Rajone të zhvilluara, ndërvarësia, male të reja, lumi Danub, deti Kaspik, Katër motorët e Europës. "smart city", toka e zjarrit.

Grupi 6. Rajone në zhvillim, OKB, male të vjetra, makia mesdhetare, zona e tundrës, Prodhimi i përgjithshëm bruto, peizazhi kulturor, gadishulli Skandinav.

Lexohet detyra nga 2 nxënës për secilin grup.

Hapi III. Përforcimi: Plotësoni diagramën e "Venit" për:



Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
1. _____ _____	1. _____ _____	1. _____ _____
_____	_____	_____

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e hartimit të testimit që do të zhvillohet në orën që vjen më pas.

Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësoj me notë 4 – 5 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimi punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.



Testim në nëntematikat: I. Rajonet dhe rajonizimi dhe II. Europa

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Testim në nëntematikat: I. Rajonet dhe rajonizimi dhe II. Europa		Situata e të nxënit: Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbledhës që është i detyrueshëm për çdo fund tremujori.	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Formon shprehje të punës së pavarur; · Mëson të shprehë formimin me shkrim; · Demonstron aftësi për të interpretuar; · Përdor informacionin në mënyrën e duhur; · Analizon situata e lidhje të ndryshme; · Seleksionon informacionin sipas nevojës; · Demonstron aftësi për të krahasuar; · Shpreh aftësi për të nxjerrë përfundime. 		Fjalët kyç: përshkrim, analizë, vlerësim, interpretim, përfundime.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Fleta e testit me të njëjtin format për çdo nxënësi.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

FAZA I. 5 min

Mësuesi orienton nxënësit lidhur me kërkesat e formatit të testit dhe shpërndan testet.

FAZA II. 40 min

Nxënësit marrin testin që është unik për të gjithë dhe punojnë gjatë gjithë orës.

FAZA III. 5 min (nga koha e pushimit)

Sapo bie zilha testet mblidhen dhe janë objekt i vlerësimit të vazhduar.

Pyetje për testim për dy grupe.

GRUPI I.

1. Mali më i lartë i Europës është:

1 pikë

- a. Mon Blan
- b. Karpatet
- c. Apenine

2. Kalon në 10 shtete:

1 pikë

- a. Vollga
- b. Reni
- c. Danubi

3. E ka sipërfaqen 10.180.000 km²:

1 pikë

- a. Rajoni i Rusisë
- b. Rajoni i Europës
- c. Rajoni i Amerikës së Veriut

4. Lidh nën det Francën me Britaninë e Madhe:

1 pikë

- a. Gothart
- b. Eurotuneli
- c. Seikon

5. Zvicra bën pjesë në rajonin e Europës:

1 pikë

- a. Perëndimore
- b. Lindore
- c. Veriore

6. Norvegjia bën pjesë në rajonin e Europës:

1 pikë

- a. Perëndimore
- b. Lindore
- c. Veriore

7. Shkruani 4 rajonet fizike të Europës:

4 pikë

8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon fizikë, rajoni i Europës, qendra urbane, Ekonomi tregu.

4 pikë

9. Rendit pesë ishuj dhe gadishuj të Europës.

5 pikë

10. Plotësoni me fjalën që duhet në vendet bosh **6 pikë**
 Në zhvillimin ekonomik të Europës gjeografët identifikojnë _____ kryesore të njohura si katër motorët e Europës: Rajoni Juglindor _____; _____ me qendër Milano; Spanja Verilindore _____; dhe Gjermania Jugperëndimore _____.

11. Analizoni veçoritë e rajoneve fizike të Europës.

7 pikë

12. Krahasoni në aspektin fiziko-gjeografik Rajonin e Europës Veriore me Rajonin e Europës Perëndimore.

8 pikë

GRUPI II.

1. Shtrihet në një hark të madh deri në kufirin lindor të saj me malet Urale:

1 pikë

- a. fusha e Lombardisë
- b. fusha e Europës Veriore
- c. fusha e Shqipërisë Perëndimore

2. Kalon në 6 shtete:

1 pikë

- a. Vollga
- b. Reni
- c. Danubi

3. Është tuneli më i gjatë në Alpet e Europës:

1 pikë

- a. Gothart
- b. Eurotuneli
- c. Seikon

4. Përshkon fushën Ruse:

1 pikë

- a. Vollga
- b. Reni
- c. Danubi

5. Aktualisht popullsia e Europës llogaritet: **1 pikë**
 a. 60 %
 b. 73 %
 c. 85 %

6. Zvicra bën pjesë në rajonin e Europës: **1 pikë**
 a. Perëndimore
 b. Lindore
 c. Veriore

7. Shkruani 4 rajonet kryesore të Europës: **4 pikë**

8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajon human, urbanizim, qendra të mëdha metropolitane, Plani Marshall. **4 pikë**

9. Rendit pesë lumenj dhe liqene të Europës. **5 pikë**

10. Plotësoni me fjalën që duhet në vendet bosh. **6 pikë**

Europa për nga pozicioni gjeografik, pr edhe nga veçoritë _____, _____ e _____ ndahet në _____ rajone krejsore: _____, _____, _____ dhe _____.

11. Analizoni rajonet klimatike dhe bimore të Botës. **7 pikë**

12. Krahasoni në aspektin fiziko-gjeografik Rajonin e Europës Veriore me Rajonin e Europës Perëndimore. **8 pikë**

Konvertimi në pikë dhe vlerësimi me notë

Pikët	0 – 10	11 – 16	17 - 24	25 – 29	30 – 34	35 – 37	38 – 40
Nota	4	5	6	7	8	9	10



Europa Ishullore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Europa Ishullore		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Ishullore?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë natyrore të rajonit të Europës Ishullore; · Dallon tiparet e popullsisë së rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të shteteve të rajonit. 		Fjalët kyçe: rajon i Europës Ishullore, basen.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim table	30’
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa Ishullore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Ishullore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar/ Plotësim table

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mëimit, si më poshtë;

1. Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore të rajonit të Europës Ishullore
2. Popullsia dhe zhvillimi ekonomik i rajonit Ishullor

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull “**Europa Ishullore**” Gjatë leximit të mëimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim table

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore			
Shtetet	Relievi	Hidrografia	Klima
Britania e Madhe, dhe Irlanda	Fusha e Anglisë, Irlandës dhe Skocisë qendrore. Malet e Skocisë dhe Peninet në qendër.	Lumi Tamiz	Klima e butë nën ndikimin e rrymës së Gjirit, me reshje pothuajse gjithë vitin.
Popullsia dhe ekonomia e rajonit			
Popullsia		Ekonomia	

Mbi 80 % e popullsisë jeton në qytet dhe Londra mbetet qyteti më i madh në Europë. Pret emigrantë. Fliten 4 gjuhë, ku më e njohura anglishtja, që në Skoci flitet me një theks të veçantë. Besimi fetar katolik, rreth 29 % deklarohen ateistë dhe vitet e fundit po rritet përqindja e popullsisë myslimane.

Dallohet për qymyr, hekur, naftë si dhe për makinat me famë Jaguar, Rolls, Morris etj. Ekonomia varet nga tregëtia dhe flota e fuqishme detare. Ekonomia e Irlandës ka pësuar rënie vitet e fundit.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Perëndimore?
2. Çfarë tiparësh ka popullsia e rajonit?
3. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të tij?
4. Tregoni në hartë rajonin, burimet ujore, shtetet dhe qytetet kryesore të tij.
5. Si ndikojnë përzjerja e gjuhëve, feve dhe kulturave në rajonin e Europës Perëndimore?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në vendet e rajonit ishullor. Pyeteni, si ndihet ai/a jo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Veprimtari praktike: Londra, qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore e Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Londra, qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore e Europës		Situata e të nxënit: Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Londra	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Lokalizon pozicionin e Londrës në Britani, si dhe në lidhje me kontinentin e Europës; · Përshkruan qytetin e Londrës, si një nga qytetet më kryesore të Europës; · Analizon zhvillimin ekonomik dhe turistik të qytetit të Londrës. 		Fjalët kyçe: Londër, megaqytet, qendër financiare, qendër tregtare, qendër politike, qendër kulturore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkurtesa, harta e Britanisë së Madhe, stilolasp, lapsa me ngjyra, laptop, video-projektor, disk.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Lexim i shpejtë/ Diskutim	7'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim harte/Punë e pavarur	30'
Hapi III. Përforcimi	Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	8'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Lexim i shpejtë/ Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Londra, qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore e Europës**

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Londra. Në vijim mësuesi fton nxënësit të lexojnë shpejt me zë të lartë, materialin në tekst në faqen 52-53 me titull “Londra, qendër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore e Europës”

Më pas kalohet në diskutim të lirë nga nxënësit duke analizuar informacionin që dëgjuan.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim harte/Punë e pavarur

Hapa për t’u ndjekur

1. Plotësoni hartën me vendndodhjen e Londrës, si dhe të qendrave kryesore urbane të Britanisë. Shpjegoni, në cilën pjesë të Britanisë gjendet? Po në lidhje me kontinentin e Europës?

2. Shkruani një raport (me 300 fjalë) mbi zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Londrës.

Hapi III. Përforcimi: Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

1. 5 -6 Nxënës do të lexojnë raportin që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

2. Cili është mesazhi i raportit që shkruat?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni raportin dhe hartën, në “Portofolin e të nxënësit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Europa Mesdhetare

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Europa Mesdhetare		Situata e të nxënësit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Mesdhetare?	
Rezultatet e të nxënësit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë natyrore të rajonit të Europës Mesdhetare; · Dallon tiparet e popullsisë së rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit të turizmit në rajon.. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Europës Mesdhetare	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa Mesdhetare**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Mesdhetare? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimin, si më poshtë;

1. Veçoritë fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Europës Mesdhetare

2. Turizmi në Europën mesdhetare

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull “**Europa Mesdhetare**” Gjatë leximit të mësimin nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore			
Shtetet	Pozita gjeografike	Relievi	Klima dhe hidrografia
Spanja, Portugalia, Italia, Greqia. Minishtete: Vatikani, San Marino, Monako, Andora, Malta dhe Qipro.	Pozitë të favorshme gjeografike në kryqëzimin e rrugëve që lidhin tre kontinente	Malet Pirenej, Kantabrike, Alpet, Apeninet, Helenidet etj. Fusha e Lombardisë në Itali etj.	Klima tipike mesdhetare. Lumenjtë kryesorë janë: Po, Tago, Duero etj., dhe liqenet Komo, Garda, në Itali etj.
Popullsia dhe turizmi i rajonit			
Popullsia	Turizmi		
Popullim të hershëm dhe të vazhdueshëm, rreth 60 % jeton në qytet, ku më të mëdha janë: Milano, Roma, Barcelona, Madrid, Lisbona, Athina etj. Besimi fetar katolik dhe ortodoks.	Turizmi është burimi kryesor i të ardhurave për të gjitha shtetet e rajonit. Potenciale të shumta natyrore, klima, riviera, male të lartë, pasuri ujore etj. Trashëgimi e pasur kulturore dhe historike; çmime më të ulëta sesa rajonet e tjera të zhvilluara etj. Zhvillimi i turizmit përveç anëve pozitive ka pasur dhe ndikim negativ në mjedis. Në Spanjë, peizazhet e Kosta Brava janë prishur në mënyrë të pakthyeshme nga ndërtime pa kriter.		

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Mesdhetare?
2. Çfarë tiparesh ka popullsia e rajonit?
3. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të tij?
4. Tregoni në hartë rajonin, burimet ujore, shtetet dhe qytetet kryesore të tij.
5. Si ndikojnë përzjerja e gjuhëve, feve dhe kulturave në rajonin e Europës Mesdhetare?
6. Pse turizmi është një nga veçoritë kryesore të Rajonit Mesdhetar?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimin punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në vendet e rajonit mesdhetar. Pyeteni, si ndihet ai/ajo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutoni në klasë.



Veprimtari praktike: Udhëtim në ishujt e Mesdheut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Udhëtim në ishujt e Mesdheut		Situata e të nxënimit: Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga ishujt e Mesdheut.	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Lokalizon vendndodhjen e ishujve të Mesdheut; · Shpjegon rëndësinë ekonomike të ishujve të Mesdheut; · Vlerëson zhvillimin e turizmit në Mesdhe. 		Fjalët kyçe: ishull, potencial turistik.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra, laptop, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	7'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim harte/Punë e pavarur	30'
Hapi III. Përforcimi	Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	8'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Udhëtim në ishujt e Mesdheut**

Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga ishujt e Mesdheut.

Më pas kalohet në diskutim të lirë nga nxënësit për ishujt e Mesdheut.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim harte/Ese përshkruese

Hapa për t'u ndjekur

1. Plotësoni hartën me vendndodhjen e ishujve Balerae, Korsikës, Sardenjës, Sicilisë, Arkipelagun e Maltës, Kretës, Rodos, Kos, Samosit etj. Shpjegoni, se cilat janë vlerat ekonomike dhe turistike të ishujve të Mesdheut?

2. Shkruani një ese përshkruese me temë: Zhvillimi ekonomik i ishujve të Mesdheut.

Hapi III. Përforcimi: Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

1. 5 -6 Nxënës do të lexojnë ese-në që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

2. Cili është mesazhi i ese-së që shkruat?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni ese-në dhe hartën, në “Portofolin e të nxënimit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Europa Lindore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Europa Lindore		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Lindore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë natyrore të rajonit të Europës Lindore; · Dallon tiparet e popullsisë së rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të shteteve të rajonit; · Shpjegon rolin e Shqipërisë si urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Europës Lindore	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Europa Lindore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën 1 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Europës Lindore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mëimit, si më poshtë;

1. Veçoritë fiziko-gjeografike dhe humane të Europës Lindore**2. Shqipëria një urë lidhëse midis Perëndimit dhe Lindjes****Lexim i orientuar**

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Europa Lindore”** Gjatë leximit të mëimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Pozita gjeografike dhe kushtet natyrore			
Shtetet	Relievi	Hidrografia	Klima
Lituani, Letoni, Bjellorusi, Ukrainë, Moldavi, Poloni, Çeki, Sllovakia, Hungari, Slloveni, Kroaci, Serbi, Bosnjë, Mali i Zi, Kosovë, Shqipëri, Bullgari, Rumani.	Alpet Dinarike, malet Ballkan, Karpate, Rodope etj. Fusha e Panonisë, ultësira Polake etj.	Lumi Danub, Sava, Vistula, Dniestër etj. Liqenet janë: Balaton, Ohrit, Shkodrës, Prespës dhe shumë liqene me origjinë akullnajore.	Klima e butë mesdhetare në brigjet perëndimore dhe kontinentale në brendësi.
Popullsia dhe ekonomia		Shqipëria një urë lidhëse midis Perëndimit dhe Lindjes	

Disa vende kanë zhvillim të dukshëm dhe janë anëtarësuar shpejt në BE. Ka dallim të dukshëm midis popujve sllav dhe jo-sllav. Në rajon ka shumë probleme të ndarjeve etnike, që shpesh janë bërë shkak i konflikteve e luftërave midis tyre. Besimi fetar ortodoks, më pak katolik, si dhe numër më të madh të shteteve me përqindje më të lartë të popullsisë myslimane.

Pozita gjeografike midis perëndimit dhe lindjes i jep atributet e një shteti urë lidhës midis dy rajoneve. Iliria ishte një vatër e rëndësishme e qytetërimit mesdhetar. Ultësira në perëndim dhe luginat ndërmallore ofrojnë mundësi për të depërtuar në brendësi të Ballkanit dhe anasjelltas. Tre rrugët më të rëndësishme nga deti Adriatik për në Lindje ndodhen në territorin e Shqipërisë; përmes luginës së Drinit, Shkumbinit dhe Vjosës. Shqipëria i ka mundësitë për të përfituar nga pozita gjeografike, duke filluar me kalimin e TAP. Anëtarësimi në NATO dhe në të ardhmen edhe në BE do të shtojë bashkëpunimin rajonal dhe përdorimin e pozitës urë lidhëse.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve.

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë natyrore të rajonit të Europës Lindore?
2. Çfarë tiparësh ka popullsia e rajonit?
3. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të tij?
4. Tregoni në hartë rajonin, burimet ujore, shtetet, qytetet kryesore të tij dhe linjën e TAP-it në Shqipëri.
5. Si ndikojnë përzierja e gjuhëve, feve dhe kulturave në rajonin e Europës Lindore?
6. Pse Shqipëria i ka të gjitha mundësitë për të përfituar nga pozita e saj gjeografike si një urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në vendet e rajonit lindor. Pyeteni, si ndihet ai/ajo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Veprimtari praktike: Danubi, lumi që bashkon disa shtete të Europës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Danubi, lumi që bashkon disa shtete të Europës		Situata e të nxënit: Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga lugina e Danubit.	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Lokalizon dhe përcakton në hartë vendet ku kalon lumi Danub; · Shpjegon ndikimin që ka Danubi në jetën ekonomike dhe kulturore të këtyre vendeve; · Analizon ndikimin e lumit Danub në biodiversitetin e vendeve ku ai kalon. 		Fjalët kyçe: lumi Danub, vende danubiane.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësja, harta e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra, laptop, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Lexim i shpejtë/ Diskutim	7'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim harte/Punë e pavarur	30'
Hapi III. Përforcimi	Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	8'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Lexim i shpejtë/ Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Danubi, lumi që bashkon disa shtete të Europës**

Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga lugina e Danubit. Në vijim mësuesi fton nxënësit të lexojnë shpejt me zë të lartë, materialin në tekst në faqen 59 me titull “Lumi Danub kalon në zemër të Budapestit”

Më pas kalohet në diskutim të lirë nga nxënësit duke analizuar informacionin që dëgjuan.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim harte/Punë e pavarur

Hapa për t'u ndjekur

1. Plotësoni hartën me emrat e vendeve ku kalon lumi Danub.
2. Shkruani një raport (me 300 fjalë) mbi ndikimin që ka Danubi në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendeve ku ai kalon.

Hapi III. Përforcimi: Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

1. 5 -6 Nxënës do të lexojnë raportin që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

2. Cili është mesazhi i raportit që shkruat?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni raportin dhe hartën, në “Portofolin e të nxënës me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Bashkimi European nga perspektiva gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Bashkimi European nga perspektiva gjeografike		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1 dhe 2 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Bashkimin European?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon krijimin dhe rritjen e Bashkimit European; · Liston sipas viteve që janë anëtarësuar shtetet e BE-së; · Përcakton insitucionet kryesore të Bashkimit European; · Vlerëson ndikimin e BE-së në ekonominë botërore. 		Fjalët kyçe: Bashkimi European	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e punës, dërrasa e zeze, shkurmesa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim/lexim i orientuar/plotësim table/ /diskutim	35'
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	5'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Bashkimi Europian nga perspektiva gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartat 1 dhe 2 në libër. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Bashkimin Europian? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim/lexim i orientuar/plotësim table/ /diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 60– 61.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të çështjes së parë, si më poshtë;

1. Krijimi dhe ecuria e Bashkimit Europian

BE me sipërfaqe 4 milion km², popullsi prej 510 milion dhe 28 shtete. BE synon të rrisë sigurinë dhe lëvizshmërinë e njerëzve, mallrave, kapitalit dhe shërbimet në tregun e brendshëm.

Lindja e BE-së lidhet me formimin e Komitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut (1951) nga 6 shtete: (Holandë, Belgjikë, Luksenburg, Gjermania Perëndimore, Francë dhe Itali).

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë çështjen e dytë të mësimit:

2. Zgjerimi i BE-së, aktualitete dhe perspektiva

Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim table: Zgjerimi i BE-së në vite të ndryshme

Viti i anëtarësimit në BE	Shtetet anëtare
1951-1957	Holandë, Belgjikë, Luksenburg, Francë, Gjermani Perëndimore dhe Itali
1973	Britania e Madhe, Danimarkë dhe Irlandë
1981	Greqia
1986	Spanjë, Portugali
1995	Austri, Finlandë, Suedi
2004	Çeki, Sllovakia, Hungari, Slloveni, Maltë, Qipro, Poloni, Estoni, Lituani, Letoni.
2007	Bullgari, Rumania
2013 -2014	Kroacia, Majote

Diskutim

Mësuesi diskuton me nxënësit për institucionet, rolin e saj në ekonominë botërore dhe perspektivën e BE-së.

Hapi III. Përfundimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Si u krijua dhe u rrit Bashkimi Europian?
2. Cilat janë institucionet kryesore të BE-së?
3. Në ç'mënyrë BE është duke rritur ndikimin e saj në ekonominë botërore?
4. Përcaktoni në hartë vendet e BE-së sipas vitit të anëtarësimit

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën. Mendoni në mënyrë kritike. Britania e Madhe ka votuar pro largimit nga në qershor 2016. Pse?

2. Në rubrikën kërkoni informacion. Pse Shqipëria ende nuk është anëtarësuar në BE?



Veprimtari praktike: Organizmat politikë dhe ekonomikë të Bashkimit Europian

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Organizmat politikë dhe ekonomikë të Bashkimit Europian		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën politike të Europës. Më pas drejton pyetjen. Çfarë dini për Bashkimin Europian?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Lokalizon në hartë vendet anëtare të BE. · Identifikon organizmat politike dhe ekonomikë të BE; · Analizon procesin e anëtarësimit në BE të Shqipërisë. 		Fjalët kyçe: Bashkimi Europian, organizma politik, organizma ekonomik	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shumësia, harta politike e Europës, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Historia, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i shpejtë/ Plotësim harte/Punë e pavarur	30'
Hapi III. Përforcimi	Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	10'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Organizmat politikë dhe ekonomikë të Bashkimit Europian**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë hartën politike të Europës. Më pas drejton pyetjen. Çfarë dini për Bashkimin Europian? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: lexim i shpejtë/Plotësim harte/ Punë e pavarur

Hapa për t'u ndjekur

1. Lexohet nga nxënësit me zë të lartë informacioni për Bashkimin Europian
2. Plotësoni hartën me emrat e vendeve anëtare të Bashkimit Europian; qyteteve ku gjenden selitë e organizmave politike dhe ekonomike të BE.

3. Shkruani një raport (me 300 fjalë) me titull: Shqiptarët dhe anglezët, pro dhe kundër anëtarësimit në BE.

Hapi III. Përforcimi: Lexim i drejtuar/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim

1. 5 -6 Nxënës do të lexojnë raportin që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

2. Cili është mesazhi i raportit që shkruat?

3. BE lufton për një Europë të bashkuar.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni raportin dhe hartën, në “Portofolin e të nxënësit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Rajoni i Ruisë. Tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike dhe kushtet natyrore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Rajoni i Ruisë. Tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike dhe kushtet natyrore		Situata e të nxënësit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër në hartat 1 dhe 2. . Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për kushtet natyrore të Ruisë?	
Rezultatet e të nxënësit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përcakton shtrirjen e Ruisë në dy kontinente; · Përshkruan tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike të Ruisë; · Vlerëson rëndësinë që kanë malet Urale për ekonominë e Ruisë; · Analizon veçoritë e kushteve natyrore të Ruisë. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Ruisë	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Biologjia, Historia, TIK-u..	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përfundimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajoni i Ruisë. Tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike dhe kushtet natyrore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër në hartat 1 dhe 2. . Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për kushtet natyrore të Ruisë?

Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Rusia pjesë e dy kontinenteve

2. Veçoritë e kushteve natyrore të Ruisë

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
-----------	------------------	--------------

<p>Shteti më i madh në botë nga sipërfaqja. Dalje në tre oqeane dhe shumë dete. Shtrihet në dy kontinente. Pjesa europiane ndahet nga malet Urale me pjesën aziatike. Në perëndim shtrihet fusha Ruse më e madhja në Europë. Lumenjtë kanë rol të rëndësishëm në ekonomi. Bimësia është e tajgës, tundrës dhe pyjet e përzierë. Është e pasur me kafshë, shpendë e insekte të shumta.</p>	<p>-Cila është rëndësia e maleve Urale për ekonominë e Rusisë? -Cilët janë 11 brezat klimatikë në Rusi? -Cilat janë veçoritë e kushteve natyrore të Rusisë?</p>	<p>Njësitë fiziko-gjeografike të Rusisë janë: fusha Ruse, malet Urale, fusha e Siberisë perëndimore, rrafshnaltat e Siberisë, malet e Azisë qendrore etj. Ka vijë të gjatë bredetare, si dhe është e varur nga Turqia. Liqenet janë deti Kaspik dhe liqeni Bajkal etj. lumenjtë kryesor janë: Vollga, Don Ural, Ob, Irtish, Jenisej etj. Rusia ndahet në 14 biorajone dhe ka rreth 139 zona të shpallura të mbrojtura.</p>
---	---	--

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Rusisë, rajonet fiziko-gjeografikë të saj dhe veçoritë fiziko-gjeografike të tyre.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajon i Rusisë

Hapi III. Përforsimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Çiklizëm në Bajkal

Grupi 2. Ariu i murrmë i Rusisë

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni ndonjë person që ka të afërm, shokë apo shoqe emigrant në Rusi. Pyeteni, si ndihet ai/ajo duke jetuar atje? Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Popullsia e Rusisë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Popullsia e Rusisë		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër grafikët 1 dhe 2. . Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Rusisë?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan ecurinë e popullsisë në Rusi; · Analizon tiparet e zhvillimit të popullsisë ruse; · Shpjegon përbërjen etnike dhe fetare të popullsisë ruse; · Evidenton problemet etnike në federatën Ruse. 		Fjalët kyçe: shtet multietnik	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e punës, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetari, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit	Koha në minuta
----------------------------	-----------------------

Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i detajuar/Diskutim	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Popullsia e Rusisë**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër në hartat 1 dhe 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Rusisë? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 66—67.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Tiparet e zhvillimit të popullsisë ruse

Shifra negative të rritjes së popullsisë vitet e fundit "katastrofë demografike". Nga 143 milion, si dhe sipas parashikimeve do të bjerë në 130 milion në vitin 2025. Rritje të madhe të numrit të vdekjeve, jetëgjatësia e meshkujve deri në 60 vjeç, ndërsa numri i të prekurve me HIV/AIDS po arrin 1 milion.

2. Shpërndarja dhe diversiteti kulturor i popullsisë ruse

Në pjesën europiane jeton pjesa më e madhe e popullsisë, ku dallohen qytetet: Moskë, Shën Petërsburg. Popullsia lëviz nga lindja drejt perëndimit. Rusia klasifikohet si shtet multietnik, ku dominojnë rusët me 81 % dhe rreth 128 grupe të tjera etnike (tartarët, ukrainasit, armenët, etj). Gjuha zyrtare rusishtja por dhe gjuhë të tjera, sipas etnive që dominojnë. Besimi fetar rreth 41 % ortodoks, 6 % mysliman, ateist 13 % etj.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: sipërmarrës të rinj, investitorë.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë tiparet e zhvillimit të popullsisë Ruse?
2. Si është shpërndarë popullsia në Rusi?
3. Cila është përbërja fetare dhe etnike e popullsisë ruse?
4. Përcaktoni qytetet me popullsi më të madhe të Rusisë.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: shtet multietnik.
2. Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Pse Rusia klasifikohet si shtet multietnik?



Zhvillimi ekonomik i Rusisë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{--të}
Tema mësimore: Zhvillimi ekonomik i Rusisë		Situata e të nxëniet: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër grafikët 1 dhe 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e Rusisë?	
Rezultatet e të nxëniet: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: · Përshkruan zhvillimin ekonomik të Rusisë; · Shpjegon fazat e transformimit nga ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu; · Përcakton veçoritë e rajoneve të mëdha ekonomike të Rusisë.		Fjalët kyçe: sipërmarrës të rinj, investitorë.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Zhvillimi ekonomik i Rusisë**

Mësuesi përdor situatën e të nxëniet në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër grafikët 1 dhe 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e Rusisë? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Zhvillimi ekonomik

2. Pasuritë minerale dhe zhvillimi rajonal i Rusisë

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Zhvillimi ekonomik i Rusisë”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Zhvillimi ekonomik	Pasuritë minerale dhe zhvillimi rajonal i Rusisë
Ekonomia e Rusisë ka pësuar ndryshime të vazhdueshme që prej vitit 1991. Procesi i privatizimit kaloi në dy faza: Faza e parë zgjati nga viti 1990 – 1998, si dhe pati një sërë ndikimesh negative në ekonomi si: rritje çmimesh, ndryshimi i rolit të shtetit, rritja e borxhit të huaj, rënie e prodhimit të investimeve, korrupsion dhe burokraci, zhvlerësim të rublës etj. Faza e dytë zgjati nga 1999 – 2001, ku rritja e çmimit të hidrokarbureve solli rimëkëmbje të ekonomisë, si dhe investitorët e rinj fituan më shumë eksperiencë për të pasur sukses në ekonominë e tregut.	Rajoni i Rusisë është më i pasuri në botë me burime natyrore. Në të gjenden pothuajse të gjithë llojet e mineraleve atyre të çmuar dhe lëndë djegëse. Rajoni Qendror i Rusisë (nënrajoni industrial qendror, i Vollgës dhe i Uraleve). Përshin pjesën europiane ose zemër të Rusisë. Zhvillimi është përqëndruar përreth Moskës dhe Shën Petërsburgut. Është dhe rajoni kryesor bujqësor i vendit. Rajoni i Siberisë, Rajoni i Kufirit Lindor dhe Rajoni i Lindjes së Largët. Këto rajone kanë pasuri të shumta minerale dhe hidroenergjetike, por nuk mund të konkurojnë rajonin qendror për shkak të kushteve shumë të vështira në to.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë ndryshimet që ka pësuar ekonomia e Rusisë që prej vitit 1991?
2. Ku synon të kalojë ekonomia ruse në të ardhmen?
3. Cilat janë veçoritë e rajoneve të mëdha ekonomike të Rusisë?
4. Përcaktoni në hartë rajonet ekonomike të Rusisë.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

1. Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Analizoni grafikun 1, 2, dhe 3. Formuloni përfundimin tuaj për: Eksportin e naftës nga Rusia sipas destinacionit.



Veprimtari praktike: Nga qyteti federal i Shën Petërsburgut në Moskë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Nga qyteti federal i Shën Petërsburgut në Moskë		Situata e të nxënët: Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Shën Petërsburgu dhe Moska.	
Rezultatet e të nxënët: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Lokalizon dhe përcakton në hartë Moskën dhe Shën Petërsburgun; · Shpjegon rëndësinë e pozicionit gjeografik të dy qyteteve më të rëndësishëm të Rusisë; · Analizon zhvillimin social-ekonomik të Shën Petërsburgut dhe Moskës; · Krahason Shën Petërsburgun me Moskën. 		Fjalët kyçe: Shën Petërsburg, Moskë, tregtare, qendër politike, qendër kulturore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Rajonit të Rusisë, stilolasp, lapsa me ngjyra. Laptop, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Lexim i shpejtë/ Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim harte/Punë e pavarur/Lexim i drejtuar	30'
Hapi III. Përforcimi	Diagram Veni	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Lexim i shpejtë/ Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Nga qyteti federal i Shën Petërsburgut në Moskë**

Mësuesi paraqet në Power Point disa foto nga Shën Petërsburgu dhe Moskë. Në vijim mësuesi fton nxënësit të lexojnë shpejt me zë të lartë, materialin në tekst në faqen 70 me titull “Shën Petërsburgu” dhe “Moska”

Më pas kalohet në diskutim të lirë nga nxënësit duke analizuar informacionin që dëgjuan.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim harte/Punë e pavarur/Lexim i drejtuar/Mbajtje shënimesh/Diskutim

Hapa për t’u ndjekur

1. Plotësoni hartën me vendndodhjen e Shën Petërsburgut dhe të Moskës.

2. Shkruani një raport (me 300 fjalë) për dy kryeqytete të Rusisë

3. 5 -6 Nxënës do të lexojnë raportin që zhvilluan në klasë. Gjatë kohës së leximit nxënësit e tjerë dëgjojnë me vëmendje dhe mbajnë shënim pjesë të informacionit që dëgjojnë por që nuk e kanë paraqitur në detyrën e tyre, ose që e kanë të paqartë dhe duhet të pyesin.

Në vijim nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit por dhe shokëve që lexuan detyrën.

4. Cili është mesazhi i raportit që shkruat?

Hapi III. Përforcimi: Plotësoni Diagramën e Venit për:

Të veçantat e Shën Petërburgut	Të përbashkëtat e dy qyteteve	Të veçantat e Moskës
1. _____	1. _____	1. _____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni raportin dhe hartën, në “Portofolin e të nxënës me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Amerika e Veriut, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Amerika e Veriut, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Veriut?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Dallon veçoritë e Amerikës së Veriut si një rajon i veçantë gjeografik; · Përshkruan klimën dhe ekosistemet e Amerikës së Veriut; · Shpjegon ndryshimet e mëdha të temperaturave midis dimrit dhe verës; · Tregon në hartë njësitë fiziko-gjeografike. 		Fjalët kyçe: uragani Katrina, fushë bregdetare, fushë e brendshme, fushat e mëdha, pellg ujor.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Amerika e Veriut, pozita gjeografike dhe veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në

libër hartat 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Veriut? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Amerika e Veriut, një rajon i veçantë gjeografik

2. Karakteristikat e mjedisit fizik

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Në këtë rajon janë shtetet SHBA dhe Kanada. Janë shtete të zhvilluara, ekonomikisht, ushtarakisht, shkallë të lartë urbanizimi, të ardhura të larta. Vendi i uraganeve.	-Si është klima në Amerikë? -Pse në brendësi të Amerikës gjenden ndryshime të mëdha të temperaturave midis dimrit dhe verës? -Cila pjesë e SHBA ka lartësi më të madhe, lindja apo perëndimi?	Kanë sisteme federale, SHBA-ja e formuar nga bashkimi i 52 shteteve dhe Kanada-ja nga bashkimi i 10 territoreve e 3 provinca. Ndahet në 4 nënrajone: fusha bregdetare e Gjirit, fusha bregdetare e Atlantikut, fusha e brendshme dhe mburoja kanadeze. Lumi Misisipi, Misuri, Jukon, Shën Lorenc etj. Liqenet e Mëdha. Klima mesatare dhe e ftohtë. Bimësia natyrore nuk ekziston, është e zëvendësuar me bimësi në funksion të ekonomisë së vendit.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Amerikës së Veriut dhe njësitë fiziko-gjeografikë të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: uragani Katrina, fushë bregdetare, fushë e brendshme, fushat e mëdha, pellg ujor.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Uraganet

Grupi 2. Tornadot

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimin punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Rajoni i Amerikës së Veriut, uragani Katrina.



Veçoritë e popullimit të Rajonit të Amerikës së Veriut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit të Rajonit të Amerikës së Veriut		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër fotot 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Amerikës së Veriut?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan mënyrën e popullimit dhe vendosjen e europeanëve në rajon; · Identifikon veçoritë dhe të përbashkëtat e popullsisë së SHBA me Kanadanë; · Analizon ritmet e rritjes së popullsisë në rajon. 		Fjalët kyçe: indigjenë, eskimezë, popullsi konsumiste	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i detajuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforcimi	Diagrama e Venit	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit të Rajonit të Amerikës së Veriut**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër fotot 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Amerikës së Veriut? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 66—67.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Amerika e Veriut, produkt i imigrimit masiv

Rreth fundit të shek. XVI, europeanët kolonizuan rajonin.

Zbulimi i njeriut Kenevik ka rizgjuar debatin e origjinës së banorëve të parë të Amerikës së Veriut.

Vendbanimet e para ishin në brigjet lindore dhe popullsia jo-europiane lëvizi drejt brendësisë.

2. Popullsia e Amerikës së Veriut sot

Kanadaja ka rreth 10 herë më pak banorë se SHBA. Janë përpjekur për të nxitur shpërndarjen e popullsisë në ët gjithë hapësirën.shkallë të lartë urbanizimi, popullsi konsumiste. Fliten tre gjuhë kryesore: anglisht, frëngjisht dhe spanjisht.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: Hispanik, indigjenë, eskimezë, popullsi konsumiste.

Hapi III. Përforcimi: Plotësoni diagramën e Venit për: SHBA dhe Kanada.

Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____

Lexohet detyra nga 5 – 6 nxënës.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Origjina e banorëve të parë të Amerikës së Veriut.



Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Veriut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Veriut		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2.. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e Amerikës së Veriut?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shpjegon mënyrën se si burimet natyrore kanë mbështetur zhvillimin ekonomik të vendeve të Amerikës së Veriut; · Identifikon produktet bujqësore që eksportojnë këto vende; · Përcakton drejtimet e reja të zhvillimit ekonomik të Kanadasë dhe SHBA. 		Fjalët kyçe: faza post industriale, sektori i tretë ekonomik, qendra e globalizimit.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Historia, Qytetari, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Veriut**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2.. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e Amerikës së Veriut? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Burimet natyrore në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Veriut**2. Organizimi hapësinor i ekonomisë së Amerikës së Veriut****Lexim i orientuar**

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Zhvillimi ekonomik në Amerikën e Veriut”** Gjatë leximit të mësimin nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim table

Burimet natyrore në mbështetje të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Veriut	Organizimi hapësinor i ekonomisë së Amerikës së Veriut
<p>Të dy shtetet janë në fazën post industriale.</p> <p>Të ardhurat kryesore sigurohen nga sektori i tretë ekonomik.</p> <p>Eksportojnë prodhime bujqësore e deri në prodhime industriale të sofistikuara dhe të teknologjisë së lartë.</p> <p>Është e pasur me minerale metalorë.</p> <p>Kanë shtuar investimet në bioteknologji dhe teknologji informacioni.</p> <p>Lugina e Silikonit shembulli më i mirë i zhvillimit.</p> <p>Kanë marrëdhënie tregtare sidomos pas krijimit të nafta.</p>	<p>Rajoni i Amerikës së Veriut është shumë i zhvilluar dhe ka një rol udhëheqës botëror.</p> <p>Dallohet një zonë qendrore e zhvillimit.</p> <p>Rajoni Qendror i Amerikës së Veriut është qendra e globalizimit.</p> <p>Rajoni detar i Verilindjes dhe Kanadaja Franceze, ku ekonomia bazohet në peshkim dhe sigurimin e lëndës drusore.</p> <p>Rajoni Jugor i quajtur ndryshe edhe “brezi i diellit”, u zhvillua pas viteve 1970 dhe ka pabarazi të mëdha të zhvillimit ekonomik brenda tij.</p> <p>Rajoni Juglindor është kompleksi kryesor botëror për prodhimet e teknologjisë së lartë.</p> <p>Rajoni i Paqësorit me qendër Kaliforninë dhe portin e Los Anxhelos-it.</p> <p>Rajoni i Kufirit Perëndimor me Las Vegasin.</p> <p>Rajoni i Brendshëm Kontinental, i cili është prodhuesi dhe përpunuesi kryesor i drithërave.</p> <p>Rajoni i Kufirit Verior, që pavarësisht pasurive të shumta natyrore ka kushte të vështira për jetesë.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Në ç’ mënyrë burimet natyrore kanë mbështetur zhvillimin ekonomik të vendeve të Amerikës së Veriut?

2. Cilat produkte bujqësore eksportojnë ato?

3. Cilat janë drejtimet e reja të zhvillimit ekonomik të Kanadasë dhe SHBA?

4. Cili prej rajoneve ekonomike është më i rëndësishëm? Pse?

5. Tregoni në hartë rajonet ekonomike të Amerikës së Veriut dhe qendrat ekonomike për secilin rajon.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimin punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni kuptimin e fjalëve kyç: yahoo, qendra e globalizimit, bioteknologji, prodhime industriale të sofistikuara. Gjetjet tuaja diskutoni në klasë.



Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Veriut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Veriut		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Amerikës së Veriut. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Amerikës së Veriut?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Shjegon rëndësinë e rajonizimit; · Plotëson hartën me emra të Rajoneve të Amerikës së Veriut me emrat e rajoneve ekonomike; · Përshkruan veçoritë e Rajoneve ekonomike të Amerikës së Veriut. 		Fjalët kyçe: Rajon i Amerikës së Veriut, rajon ekonomik.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shumësia, harta e Rajonit të Amerikës së Veriut, stilolaps, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Veriut**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Amerikës së Veriut. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajoneve ekonomike të Amerikës së Veriut? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për rajonet ekonomike të Amerikës së Veriut.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Identifikoni rajonet
2. Plotësoni hartën me emrat e tyre
3. Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin rajon
4. Plotësoni hartën me nga një veçori kryesore të çdo rajoni ekonomik

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajon i Amerikës së Veriut, rajon ekonomik.
2. Cilat janë karakteristikat kryesore të rajoneve ekonomike të Amerikës së Veriut?

Nxënësit mbajnë shënime përgjegjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajoni i Amerikës së Veriut”, në “Portofolin e të nxëniet me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Amerika e Mesme, pozita gjeografike dhe kushtet natyrore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Amerika e Mesme, pozita gjeografike dhe kushtet natyrore		Situata e të nxëniet: Mësuesi i fton nxëniet të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Mesme?	
Rezultatet e të nxëniet: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Dallon veçoritë e Amerikës së Mesme si një rajon i veçantë gjeografik; · Përshkruan relievin dhe klimën e Amerikës së Mesme; · Evidenton kulturat bujqësore që rriten në këtë rajon dhe kërkohen në të gjithë botën; · Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Amerikës së Mesme. 		Fjalët kyçe: kanali i Panamasë, ekorajone.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Biologjia, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përfundimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Amerika e Mesme, pozita gjeografike dhe kushtet natyrore**. Mësuesi përdor situatën e të nxëniet në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxëniet të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Mesme? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxëniet të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Pozita gjeografike e Amerikës së Mesme

2. Format kryesore të relievit dhe kushtet natyrore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

DI	DUA TË DI	MËSOJ
<p>Ëhtë një rajon që përbëhet nga shtete të vegjël, Meksika më i madhi dhe shtetet ishullorë në detin e Karaibeve.</p> <p>Kanë dalje në det dhe kanë mundësi për turizëm dhe peshkim.</p> <p>Ka forma të ndryshme relievi.</p> <p>Klima mesatare me ndryshime të mëdha vjetore të temperaturave.</p> <p>Zona ishullore preket shpesh nga uraganet.</p>	<p>-Në ç'mënyrë ndikon pozita gjeografike e Amerikës së Mesme në zhvillimin ekonomik të vendeve që ndodhen atje?</p> <p>-Cilat janë kulturat bujqësore më të kërkuara në të gjithë botën që rriten në Amerikën e Mesme?</p> <p>-Si janë formuar ishujt Bahamas?</p> <p>-Pse Karaibet preken nga tërmetet?</p> <p>-Pse po krijohen ekorajonet?</p>	<p>Përbëhet nga 7 shtete, ishujt Antilet e Mëdha dhe të Vogla.</p> <p>Shumica e ishujve janë formuar nga veprimtaria e vullkaneve.</p> <p>Në Meksikë janë 2 vargje malorë paralele: Sierra Madre Perëndimore dhe Lindore, ku midis tyre gjendet Rrafshnalta Meksikane.</p> <p>Këtu ndodhet dhe Kanioni Kopër më i madh se ai në SHBA.</p> <p>Republikat e tjera kanë reliev fushor dhe male të ulëta.</p> <p>Rajoni përmban 7 % të biodiversitetit botëror.</p>

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Amerikës së Mesme dhe njësitë fiziko-gjeografikë të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: kanali i Panamasë, ekorajone.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Kanali i Panamasë

Grupi 2. Tërmetet në Karaibe

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Cilat janë veçoritë e pyllit të pishave dhe lisit në Amerikën e Mesme?



Veçoritë e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Mesme

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Mesme		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Mesme?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan tiparet e e popullsisë së Amerikës së Mesme; · Shpjegon ndryshimet ekonomike në zhvillimin e vendeve të rajonit; · Evidenton pasuritë kryesore të vendeve të rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Meksikës. 		Fjalët kyçe: metis, mulat, plantacion, qendër metropolitane, Meksiko City	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e punës, dërrasa e zeze, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përfundimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Mesme**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Mesme? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Tiparet e popullsisë së Amerikës së Mesme

2. Zhvillimi ekonomik i Amerikës së Mesme

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit dhe të zhvillimit ekonomik të Amerikës së Mesme”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Tiparet e popullsisë së Amerikës së Mesme	Zhvillimi ekonomik i Amerikës së Mesme
<p>Ritme të larta të shtimit të popullsisë, nivele të larta të vdekshmërisë dhe emigrim në rritje.</p> <p>Shteti me popullsi më të lartë Meksika, si dhe kryeqyteti i saj Meksiko City me 9 milion dhe si metropol rreth 20 milion.</p> <p>Këtu ka lulëzuar qytetërimi Maja..</p> <p>Rajoni ka diversitet të lartë kulturor dhe përzierje të popullsisë.</p> <p>Këtu ka pak popullsi vendase, metis, mulat, zambo, afrikanë.</p> <p>Gjë zyrtare janë spanjisht, portugalisht, anglisht në Belize, frëngjisht, gjermanisht etj.</p> <p>Besimi fetar është katolik, por praktikohen ritet katolike të përzjera me ato të besimit fetar vendas.</p>	<p>Vendet e Amerikës së Mesme hyjnë në grupin e shteteve në zhvillim.</p> <p>Plantacionet janë fusha të mbjella me një lloj bime si: kafe, kallam sheqeri, banane etj.</p> <p>Shtetet ishullore kanë pasuri natyrore për t'u përfshirë në tregun botëror.</p> <p>Turizmi siguron rreth 60 % të prodhimit të përgjithshëm bruto.</p> <p>Produktet bujqësore eksportohen në tregun botëror si: banane, qitro, kafe etj.</p> <p>Meksika ka ritme të shpejta ekonomike, por pa arritur nivelin e vendeve të zhvilluara. Ajo ka industri moderne, bujqësi dhe turizëm.</p> <p>Pas nënshkrimit të marrëveshjes NAFTA-s janë hapur industri në kufirin verior.</p> <p>Hapja e maquiladorave ka sjellë rritje të punësimit në rajonin periferik dhe ndryshim të drejtimit të migrimit të brendshëm.</p>

Hapi III. Përfundimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë tiparet e popullsisë së Amerikës së Mesme?
2. Në ç'mënyrë ka ndryshuar ekonomia e vendeve të Amerikës së Mesme?
3. Cila është pasuria kryesore e vendeve të rajonit?
4. Cilat janë veçoritë e zhvillimit ekonomik të Meksikës?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni kuptimin e: grupi i shteteve në zhvillim, plantacione bregdetare, qendra metropolitane. Formuloni përfundimin tuaj.



Amerika e Jugut dhe veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Amerika e Jugut dhe veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Jugut?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Dallon veçoritë e Amerikës së Jugut si një rajon i veçantë gjeografik; · Përshkruan klimën dhe ekosistemet e Amerikës Jugore; · Shpjegon pse në Amerikën e Jugut gjenden një shumëllojshmëri klimash; · Tregon në hartë njësitë fiziko-gjeografike. 		Fjalët kyçe: Pampas, gjarpri anakonda	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Biologjia, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përfundimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Amerika e Jugut dhe veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Amerikën e Mesme? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Pozita gjeografike e Amerikës së Jugut

2. Format kryesore të relievit dhe kushtet natyrore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën "Di" shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën "Dua të di" shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën "Mësoj" shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Rajoni i Amerikës Jugore shtrihet në hemisferën perëndimore dhe laget në perëndim nga oqeani Paqësor dhe në lindje nga ai Atlantik. Ka formën e një trekëndëshi. Pozita gjeografike e ishujve jugorë pas hapjes së kanalit të Panamasë.. Në relievin e rajonit zonat malore dhe ato fushore. Pylli i Amazonës quhet ndryshe dhe mushkëria e botës. Lumi i madh i botës Amazona.	-Si janë format e brigjeve të Amerikës? -Çfarë shenjash të drejtimit të kontinentit janë dukshëm domethënëse në Amerikën e Jugut? -Pse në Amerikën e Jugut gjendet një shumëllojshmëri klimash? -Pse pozita gjeografike e ishujve jugorë nuk është më shumë e rëndësishme.	Andet janë vazhdim i Kordilierëve dhe ka 30 maja mbi 6000 m. Malësitë e Guajanës, rrafshnalta e Brazilit, e Patagonisë, fusha e Amazonës, ultësira e Paranës. Zonat fushore në Uruguaj quhet pampas dhe Amazonë quhet serado. Lumenj të tjerë janë: Parana, Uruguaj, Orinoko, ujëvarat Iguasu, si dhe liqeni Titikaka.

Pas përfundimit të plotësisht dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Amerikës së Jugut dhe njësitë fiziko-gjeografikë të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjalë ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Pampas, gjarpri anakonda.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasë në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Pampa

Grupi 2. Pylli i Amazonës

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimi punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni kuptimin e fjalëve kyç: pampa, piranjat. Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Amerika e Jugut, popullsia dhe ekonomia

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Amerika e Jugut, popullsia dhe ekonomia		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Amerikës së Jugut?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan tiparet e e popullsisë së Amerikës së Jugut; · Shpjegon ndryshimet kulturore të popujve dhe problemet sociale që ka rajoni; · Evidenton pasuritë kryesore të vendeve të rajonit; · Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Brazilit dhe Argjentinës. 		Fjalët kyçe: Brazili, Argjentina, Kordova	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Amerika e Jugut, popullsia dhe ekonomia**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin

ekonomik të Rajonit të Amerikës së Jugut? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabelle

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Tiparet dhe shpërndarja e popullsisë së Amerikës së Jugut

2. Ekonomia e Amerikës së Jugut

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Amerika e Jugut, popullsia dhe ekonomia”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Tiparet dhe shpërndarja e popullsisë së Amerikës së Jugut	Ekonomia e Amerikës së Jugut
<p>Pjesa e popullsisë vendase që mbijetoi u lokalizua në brendësi të Amazonës dhe lartësitë e Andeve. Popullsia dallohet për nivelin dhe ritmin e shpejtë të urbanizimit.</p> <p>Shtetet më të urbanizuara janë Argjentina, Uruguaj, Venezuela, Brazili dhe Kili.</p> <p>Lëvizja e popullsisë drejt qyteteve ka krijuar lagjet e varfra në periferi ose “favelas”.</p> <p>Kolonizimi i gjatë ka krijuar një mozaik kulturash. Përçindjen më të lartë të popullsisë e zënë europianët, metisët, mulatët, zambot, vendasit, afrikanët dhe një komunitet i vogël aziatikësh.</p> <p>Gjuhët kryesore që fliten në rajon janë: portugalisht, spanjisht, frëngjisht, gjermanisht dhe gjuhët vendase më të përhapurat janë Quekua, Guaran, Ajmara etj.</p> <p>Mbi 90 % janë katolik, më pak protestant, si dhe besimet animizëm, dhe shamanizëm të vendasve.</p>	<p>Shumica e vendeve kanë ekonomi të bazuar në nxjerrjen e mineraleve dhe bujqësi.</p> <p>Marrëveshjet Merkosur, Unasur, CAN etj., kanë lehtësuar tregtinë dhe zhvillimin e përbashkët.</p> <p>Guajana dhe Surinami kanë ferma të mëdha që prodhojnë për eksport.</p> <p>Kolumbia dhe Venezuela janë të pasura me naftë, ndërsa Peru-ja ka industri peshku.</p> <p>Bolivia e pasur me zink, bakër etj, ndërsa Ekuatori eksporton sasi të mëdha karkaleca deti, kurse Kili eksporton prodhime deti.</p> <p>Brazili ka pasuri minerale të shumta, toka bujqësore shumë të mira dhe eksporton kafe, sojë etj.</p> <p>Argjentina përpunon prodhime bujqësore dhe blegtorale të pampas.</p> <p>Rajoni ka pasuri të shumta, por niveli i varfërisë mbetet akoma i lartë.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë tiparet e popullsisë së Amerikës së Jugut?
2. Cilët vende e kolonizuan më shumë Amerikën e Jugut?
3. Cilat janë shtetet më të urbanizuara të Amerikës së Jugut?
4. Cilat janë problemet sociale që ka sjellë lëvizja e popullsisë drejt qytetit?
5. Pse në Amerikën e Jugut gjenden një mozaik kulturash e popujsh?
6. Në ç’mënyrë ka ndryshuar ekonomia e vendeve të Amerikës së Jugut?
7. Cilat aktivitete ekonomike janë të rëndësishme në Amerikën e Jugut?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Gjeni kuptimin e fjalëve: animizëm, shamanizëm. Gjetjet tuaja diskutojini në klasë.



Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Mesme dhe Rajoni i Amerikës Jugore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Mesme dhe Rajoni i Amerikës Jugore		Situata e të nxënimit: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore?	
Rezultatet e të nxënimit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Shjegon rëndësinë e rajonizimit; Plotëson hartën me emra të Rajoneve të Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore me emrat e nënrajoneve dhe shteteve më të zhvilluara në këto dy rajone; Përshkruan veçoritë e Rajonit të Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Amerikës së Mesme, Rajoni i Amerikës Jugore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Rajonit të Amerikës së Mesme dhe e Rajonit të Amerikës Jugore, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajoni i Amerikës së Mesme dhe Rajoni i Amerikës Jugore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënimit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

- Identifikoni rajonet
- Plotësoni hartën me emrat e tyre
- Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin rajon
- Plotësoni hartën me emrat e shteteve më të zhvilluara të Amerikës Jugore.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

- Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajoni i Amerikës së Mesme, Rajoni i

Amerikës Jugore..

2. Cilat janë karakteristikat kryesore të shteteve më të zhvilluara të Amerikës së Mesme dhe Amerikës Jugore?

Nxënësit mbajnë shënime përgjegjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajoni i Amerikës së Mesme dhe Rajoni i Amerikës Jugore”, në “Portofolin e të nxënësit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës Ora e dytë e projektit, me temë: Ecuria e punës me projektin		Situata e të nxënësit: Nxënësit e dinë se ç’është projektin. Diskutim me nxënësit për ecurinë e punës së projektit.	
Rezultatet e të nxënësit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Argumenton zgjedhjen temës së miniprojektit të grupit; · Shpreh dëshirën për të bashkëpunuar; · Organizon informacionin e marrë; · Fiton shprehje për t’u organizuar. 		Fjalët kyç: Projekt kurrikular, rezultate të nxënësve gjatë projektit, burime informacioni, grup pune, mjedis pune G 6, G 8.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, Interneti, Literaturë gjeografike.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetari, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim i lirë	5’
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Vëzhgim i detajuar/ Punë në grupe	30’
Hapi III. Përfundimi	Diskutim/ Punë në grupe	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim i lirë

Nxënësit tregojnë materialet e grumbulluara nga burime të ndryshme, vështirësitë osë arritjet gjatë realizimit të projektit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Vëzhgim i detajuar /Punë në grupe

Klasa është ndarë në grupe, ku secili grup ka temën e miniprojektit si më poshtë.

Grupi 1. Francë

Grupi 2. Gjermani

Grupi 3. Itali

Grupi 4. Britani e Madhe

Grupi 5. Rusi

Grupi 6. Japoni

Grupi 7. SHBA

Grupi 8. Kanada

Nxënësit mbajnë shënime mbi vërejtjet dhe sugjerimet që jepen brenda çdo grupi.

Në secilin grup bëhet seleksionimi i materialeve, ku eksperti i grupit përcakton mënyrën se si do të vazhdohet projekti.

Nxënësit mbajnë shënime mbi vërejtjet dhe sugjerimet që jepen brenda çdo grupi.

Hapi III. Përforcimi: Diskutim/ Punë në grupe

Ndahen detyrat për ecurinë e mëtejshme të projektit.

Nxënësit i drejtojnë pyetje mësuesit lidhur me zhvillimin e projektit.

Vlerësimi: Vlerësim me gojë, individual për seleksionimin e materialit së projektit.

Detyra dhe punë e pavarur

Nxënësit e grupit parë, të dytë, të tretë dhe të katërt organizojnë prezantimin përfundimtar të projektit.



Përsëritje në nëntematikat: II. Europa, III. Rajoni i Ruisë, IV. Rajoni i Amerikës së Veriut, V. Rajoni i Amerikës së Mesme dhe VI. Rajoni i Amerikës së Jugut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Përsëritje në nëntematikat: II. Europa, III. Rajoni i Ruisë, IV. Rajoni i Amerikës së Veriut, V. Rajoni i Amerikës së Mesme dhe VI. Rajoni i Amerikës së Jugut		Situata e të nxënësve: Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor tabelën e koncepteve. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Proveni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Përshkruan veçoritë kryesore fiziko-gjeografike dhe humane të rajonit të Europës Ishullore, Mesdhetare dhe Lindore; · Përshkruan historinë e formimit, zhvillimit e zgjerimit të Bashkimit Europian; · Identifikon dhe ndan ide për disa nga problemet e sotme rajonale të Europës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre. · Dallon veçoritë e popullimit dhe natyrën e zhvillimit ekonomik të Ruisë në botën moderne; · Interpreton me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të rajoneve të Amerikave dhe rolin e saj në marrëdhënie me rajonet e tjera; · Analizon të dhëna dhe nxjerr përfundime për veçortitë e popullimit të rajonit dhe shkallën e ndikimit të migracionit në tiparet e popullsisë dhe kulturës së sotme; 		Fjalët kyç: rajoni i Europës Ishullore, rajoni i Europës Mesdhetare, rajoni i Europës Lindore, Bashkimi Europian, rajoni Rus, rajoni i Amerikës Veriore, rajoni i Amerikës Qendrore, rajoni i Amerikës Jugore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, harta mësimore, dërrasa e zezë, shkumësa, laptop, video-projektor, disk flipçart, fleta formati, lasp.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Tabela e koncepteve	10'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim tabele/Diskutim	25'
Hapi III. Përforcimi	Diagrama e Venit/Diskutim	10'

Organizimi i orës së mësimt

Hapi I. Parashikimi: Tabela e koncepteve

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Përsëritje në nëntematikat: I. Europa, II. Rajoni i Rusisë, III. Rajoni i Amerikës së Veriut, IV. Rajoni i Amerikës së Mesme dhe V. Rajoni i Amerikës së Jugut**

Ora e mësimt fillon me prezantimin e çështjeve për diskutim, të sugjeruara nga nxënësit, sepse orën që vjen më pas do të zhvillohet provim dhe nxënësit parashetrojnë ato çështje të cilat duan dhe shpjegime.

Në vijim mësuesi shpjegon paqartësitë që kanë nxënësit.

Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor tabelën e koncepteve. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë. Nxënësit tabelën e koncepteve e kanë dhe në libër.

1. Plotësoni tabelën e koncepteve për veçoritë dalluese të rajoneve të Europës Ishullore, Mesdhetare dhe Lindore:

Rajonet	Shtetet që përfshin	Karakteristikat dalluese të rajonit
Europa Ishullore		
Europa Mesdhetare		
Europa Lindore		

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim table/Diskutim.

Nxënësit ndërtojnë në fletore tabelat që kanë në libër dhe i plotësojnë.

1. Plotësoni tabelën: Zgjerimi i BE-së në vite të ndryshme.

1951-1957	1973	1981	1986	1995	2004	2007	2013 - 2014

2. Plotësoni tabelën e koncepteve për veçoritë dalluese të rajoneve të Amerikës Qendrore dhe Amerikës Jugore:

Rajonet	Shtetet që përfshin	Karakteristikat dalluese të rajonit
Amerika Qendrore		
Amerika Jugore		

Diskutim me nxënësit pasi kanë plotësuar tabelën.

Hapi III. Përforcimi: Plotësoni diagramën e Venit për:

Rusi SHBA

Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e hartimit të testimit që do të zhvillohet në orën që vjen më pas.

Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësoj me notë 4 – 5 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimt punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.



Testim në nëntematikat: II. Europa, III. Rajoni i Ruisë, IV. Rajoni i Amerikës së Veriut, V. Rajoni i Amerikës së Mesme dhe VI. Rajoni i Amerikës së Jugut

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Testim në nëntematikat: II. Europa, III. Rajoni i Ruisë, IV. Rajoni i Amerikës së Veriut, V. Rajoni i Amerikës së Mesme dhe VI. Rajoni i Amerikës së Jugut		Situata e të nxënësve: Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmblendhës që është i detyrueshëm për çdo fund tremujori.	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> · Formon shprehje të punës së pavarur; · Mëson të shprehë formimin me shkrim; · Demonstron aftësi për të interpretuar; · Përdor informacionin në mënyrën e duhur; · Analizon situata e lidhje të ndryshme; · Seleksionon informacionin sipas nevojës; · Demonstron aftësi për të krahasuar; · Shpreh aftësi për të nxjerrë përfundime. 		Fjalët kyç: përshkrim, analizë, vlerësim, interpretim, përfundime.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Fleta e testit me të njëjtin format për çdo nxënës.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

FAZA I. 5 min

Mësuesi orienton nxënësit lidhur me kërkesat e formatit të testit dhe shpërndan testet.

FAZA II. 40 min

Nxënësit marrin testin që është unik për të gjithë dhe punojnë gjatë gjithë orës.

FAZA III. 5 min (nga koha e pushimit)

Sapo bie zilha testet mbledhen dhe janë objekt i vlerësimit të vazhduar.

Pyetje për testim për dy grupe.

GRUPI I.

1. Pas Zbulimeve të Mëdha Gjeografike arriti të quhej "mbretëresha e deteve". 1 pikë
 - a. Anglia
 - b. Spanja
 - c. Belgjika
2. Malet Urale janë në: 1 pikë
 - a. Itali
 - b. Rusi
 - c. Belgjikë
3. Italia bën pjesë në rajonin e Europës: 1 pikë
 - a. Perëndimore
 - b. Mesdhetare
 - c. Veriore
4. Ka sistem federal dhe është formuar nga bashkimi i 52 shteteve: 1 pikë
 - a. SHBA
 - b. Kanada
 - c. Rusi
5. Është shteti më i zhvilluar në Rajonin e Amerikës së Mesme: 1 pikë
 - a. Itali
 - b. Kina

- c. Meksika
6. Brazili dhe Argjentina janë dy shtetet më të zhvilluara në rajonin: **1 pikë**
- a. e Amerikës së Mesme
- b. e Amerikës Veriore
- c. e Amerikës Jugore
7. Shkruani qytetet më të rëndësishëm dhe me përqëndrim të lartë të popullsisë në rajonin e Europës Mesdhetare: **4 pikë**
8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajoni i Europës Mesdhetare, Bashkimi European, rajoni Rus, rajoni i Amerikës Veriore. **4 pikë**
9. Rendit pesë lumenj në rajonin e Amerikës së Veriut. **5 pikë**
10. Shpjegoni në ç'mënyrë ndikon pozita gjeografike e Amerikës së Mesme në zhvillimin ekonomik të vendeve që ndodhen atje. **6 pikë**
11. Analizoni zhvillimin ekonomik të vendeve të Rajonit të Amerikës së Jugut. **7 pikë**
12. Krahasoni Rajonin e Europës Ishullore me Rajonin e Europës Mesdhetare. **8 pikë**
- GRUPI II.**
1. Në këtë rajon të Europës gjenden 5 minishtete: **1 pikë**
- a. Mesdhetare
- b. Lindore
- c. Veriore
2. Quhet dhe qyteti i gondolave: **1 pikë**
- a. Firenze
- b. Venecia
- c. Milano
3. Bullgaria bën pjesë në rajonin e Europës: **1 pikë**
- a. Perëndimore
- b. Lindore
- c. Veriore
4. U bë anëtare e BE-së në vitin 2013: **1 pikë**
- a. Itali
- b. Rusi
- c. Kroacia
5. Ka sistem federal dhe është formuar nga bashkimi i 10 territoreve e 3 provincave: **1 pikë**
- a. SHBA
- b. Kanada
- c. Rusi
6. Lumi i Amazonës ndodhet në rajonin: **1 pikë**
- a. e Amerikës së Mesme b. e Amerikës Veriore c. e Amerikës Jugore
7. Shkruani 4 nënrajonet fizike të rajonit të Amerikës së Veriut: **4 pikë**
8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajoni i Europës Ishullore, rajoni i Europës Lindore, rajoni i Amerikës Qendrore, rajoni i Amerikës Jugore. **4 pikë**
9. Rendit pesë lumenj në Rajonin Rus. **5 pikë**
10. Shpjegoni veçoritë e zhvillimit ekonomik të Meksikës. **6 pikë**
11. Analizoni mundësitë që ka Shqipëria për të përfituar nga pozita e saj gjeografike si një urë lidhëse midis Lindje dhe Perëndimit. **7 pikë**
12. Krahasoni Federatën Ruse me SHBA. **8 pikë**

Konvertimi në pikë dhe vlerësimi me notë

Pikët	0 – 10	11 – 16	17 - 24	25 – 29	30 – 34	35 – 37	38 – 40
Nota	4	5	6	7	8	9	10



Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore, veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore, veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1 dhe 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon veçoritë e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore si një rajon i veçantë gjeografik; Shpjegon emërtimet e ndryshme që përdoren për rajonin; Përshkruan relievin dhe klimën e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore; Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të rajonit. 		Fjalët kyçe: gamile, deve, Egjipt, Mesopotami, Nili, Kaukaze, duna ranore, oaze.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përfundimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore, veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Tiparet kryesore të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore

2. Nga shkretëtirat në Mesopotami

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën "Di" shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën "Dua të di" shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën "Mësoj" shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Ka dalje në Mesdhe. shkretëtira e Saharasë shtrihet në jug të Afrikës Veriore. Këtu kanë lindur qytetërimet e hershme botërore dhe tre besimet kryesore fetare. Në brigjet e Mesdheut klimë mesdhetare. Rajoni është i varfër me burime të ujit të pijshëm.	-Sa e rëndësishme është pozita gjeografike e vendeve të rajonit? -Cila është rëndësia historike e rajonit? -Cilat janë veçoritë e relievit dhe të klimës së rajonit?	Hapja e kanalit të Suezit shkurtoi shumë distancat midis vendeve të Europës. Rajoni emërtohet Bota e Thatë, Lindje e Mesme, Lindje e Afërt dhe Bota Islame. Njësitë fiziko-gjeografike janë malet Atlas, Zagros, Taurus, shkretëtira e Saharasë, Nefudi i Madh, Nefudi i Vogël, Rub El Ali, pllaja e Iranit, ultësira e Mesopotamisë. Bota shtazore është shumë e pasur si: deve, gamilje etj. Lumi Nili, Tigër, Euftrat, Amur Darja etj. Deti Kaspik, liqeni Aral.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore dhe njësitë fiziko-gjeografike të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjalë ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: gamile, deve, Egjipt, Mesopotani, Nili, Kaukaze, duna ranore, oaze.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Kanali i Suezit

Grupi 2. Oazi Ubari në Sahara

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Për shkretëtirën e Saharasë. Shkruani një ese "Si do të ishte jeta juaj në se do të jetonit jetonit?"



Veçoritë e popullimit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veçoritë e popullsisë së rajonit; • Evidenton problemet shoqërore që ka sjellë procesi i urbanizimit në qytetet kryesore të rajonit; • Dallon etnitë, gjuhët kryesore, besimet fetare në rajon; • Analizon marrëdhëniet midis besimeve fetare në këtë rajon. 		Fjalët kyçe: oaze, Nili, kurdë, islami, Jerusalem	

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.

Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Veçoritë e popullsisë së rajonit

2. Bashkëjetesë e vështirë kulturash dhe besimesh fetare

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Veçoritë e popullsisë së rajonit	Bashkëjetesë e vështirë kulturash dhe besimesh fetare
<p>“Ku ka ujë ka jetë”.</p> <p>Shpërndarja e popullsisë është e pabarabartë.</p> <p>Shtetet më të populluara të rajonit janë Turqia, Egjipti dhe Irani me mbi 65 milion banorë secila.</p> <p>Ritmet e urbanizimit janë të larta.</p> <p>Ka qytete të mbipopulluara si: Stambolli, Kajro, Teherani, Bagdati etj.</p> <p>Qeveritë e disa shteteve po i përgjigjen kësaj situatë duke marrë masa të ndryshme: p.sh. Irani ka ngritur shumë zyra qeveritare në qytetet e tjera për të pakësuar numrin e njerëzve që shkojnë drejt Teheranit.</p>	<p>Rajoni ka një numër të madh etnish dhe besimesh fetare.</p> <p>Konfliktet midis tyre kanë qenë dhe vazhdojnë akoma.</p> <p>Konflikti kurdë dhe turqve, palestinezëve dhe izraelitëve.</p> <p>Grupin më të madh etnik e përbëjnë arabët, të cilët janë përhapur gjerësisht dhe në disa shtete kanë pushtetin në duar.</p> <p>Berberët dhe Tuaregët bëjnë jetë endacake në Sahara.</p> <p>Gjuha kryesore është arabishtja, dhe besimi kryesor është islam.</p> <p>Këtu kanë lindur tre besime fetare: islam, krishterimi dhe judaizmi.</p> <p>Jerusalemi konsiderohet si vend i shenjtë për të tre këto besime.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë veçoritë e popullsisë së rajonit?
2. Çfarë problemesh shoqërore ka sjellë procesi i urbanizimit në qytetet kryesore?
3. Cilat janë etnitë kryesore që jetojnë në këtë rajon?
4. Po besimet fetare kryesore?
5. Si janë marrëdhëniet midis tyre?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Formuloni përfundimin tuaj: Gjuha e berberëve dhe tuaregëve, cila është?



Zhvillimi ekonomik në Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{--të}
Tema mësimore: Zhvillimi ekonomik në Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, foton 1 dhe grafikun 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e vendeve të Rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përkshuan pabarazinë e dukshme ekonomike rajonale, si edhe brenda shteteve; • Shpjegon pse Siria dhe Libia nuk po njohin rritje të zhvillimit ekonomik; • Analizon veprimtarinë e organizatave ekonomike që veprojnë në rajon. 		Fjalët kyçe: Arabia Saudite, Ari i Zi, Lidhja Arabe, OPEC	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Shpjegim i detajuar/Diskutim	30'
Hapi III. Përforsimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Zhvillimi ekonomik në Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore**. Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, foton 1 dhe grafikun 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për ekonominë e vendeve të Rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim i përparuar/Diskutim

Nxënësit hapin librat në fq. 94—95.

Shkruaj në tabelë vetëm çështjet kryesore të mësimit, si dhe ndalem në shpjegimin e detajuar të secilës prej tyre si më poshtë;

1. Tipare të zhvillimit ekonomik të Afrikës Veriore dhe Azia Jugperëndimore

Rajoni është i pasur me burime natyrore, si dhe përmban 60 % të rezervave botërore të naftës.

Ekonomia në disa shtete nuk po njih rritje, si rrjedhojë e rënies së çmimit të naftës dhe konflikteve.

Më të prekurat nga konfliktet kanë qenë Siria dhe Libia ku prodhimi i naftës ra me 40 % dhe u dëmtuan fushat naftëmbajtëse dhe infrastruktura për prodhimin e naftës.

Egjipti dhe Maroku kanë pasur rritje më të madhe ekonomike, por pritet që edhe shtete të tjera të vazhdojnë të kenë rritje deri në 3 % në vit.

2. Ekonomia e varur nga “Ari i Zi”

Ekonomia e shumicës së vendeve të rajonit varet nga nxjerrja dhe përpunimi i naftës.

Prodhimi dhe eksportimi i naftës ka siguruar të ardhura të larta për disa vende, të cilat i kanë përdorur ato për të shtuar llojet e prodhimeve dhe investimet në industrinë tekstile, agroindustri dhe industrinë portuale.

Vendet me ekonomi të suksesshme cilësohen: Egjipiti, Turqia, Libani dhe Izraeli.

Egjipti ka industri, bujqësi dhe turizëm të zhvilluar.

Izraeli ka teknologji të lartë, PPB të lartë, bazë të fuqishme industriale dhe eksporte bujqësore fitimprurëse etj.

Libani është duke rindërtuar ekonominë e tij dhe Turqia ka shtuar shumëllojshmërinë e prodhimeve.

Organizatave kryesore që veprojnë në rajon janë Lidhja Arabe dhe OPEC.

Nxënësit duke dëgjuar shpjegimin diskutojnë.

Në vijim mësuesi pyet nxënësit nëse kanë paqartësi për njohuritë e reja që u transmetuan.

Është shumë e rëndësishme të evidentohen kuptimet e termave: Arabia Saudite, Ari i Zi, Lidhja Arabe, OPEC.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Pse në Afrikën Veriore dhe Azinë Jugperëndimore ka pabarazi të dukshme ekonomike rajonale si edhe brenda vetë shteteve?

2. Pse Siria dhe Libia nuk po njohin rritje të zhvillimit ekonomik?

3. Cila është veprimtaria e organizatave ekonomike që veprojnë në rajon?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkon informacion. Për jetën ekonomike në Siri sot. Formuloni përfundimin tuaj në një paragraf.



Veprimtari praktike: Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore

<p>Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore</p>	<p>Shkalla: IV</p>	<p>Klasa: 8^{-të}</p>
<p>Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotëson hartën me emrat e vendeve që përbëjnë rajonin; • Analizon emërtimet e ndryshme për rajonin; • Identifikon vendet më të zhvilluara të rajonit. 	<p>Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore?</p> <p>Fjalët kyçe: Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore</p>	
<p>Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore, stilolasp, lapsa me ngjyra.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për rajonin e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Identifikoni vendet që përbëjnë rajonin.
2. Plotësoni hartën me emrat e tyre
3. Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin vend
4. Plotësoni hartën me nga një veçori kryesore të çdo vendi

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjalë ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore.

2. Analizoni emërtimet e ndryshme të rajonit.

Nxënësit mbajnë shënime përgjegjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore”, në “Portofolin e të nxënës me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



KIMI I ORËS MËSIMORE

Afrika Nënshaharane dhe veçoritë fiziko-gjeografike

qëria dhe mjedisi Lënda: Gjeografi		Shkalla: IV	Klasa: 8
Tema mësimore: Afrika Nënshaharane dhe veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Afrikën Nënshaharane?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon veçoritë e Afrikës Nënshaharane si një rajon i veçantë gjeografik; Përshkruan relievin dhe klimën e rajonit; Evidenton disa nga bimët dhe kafshët që rriten në këtë rajon; Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Afrikës Nënshaharane. 		Fjalët kyçe: Afrikën Nënshaharane, Greit Rift Vallej.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Afrika Nënshaharane dhe veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Afrikën Nënshaharane? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Afrikën Nënshaharane, Greit Rift Vallej.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Pozita gjeografike e Afrikës Nënshaharane

2. Format kryesore të relievit dhe kushtet natyrore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Rajoni ndahet nga Afrika Veriore nga shkretëtira e Saharasë në veri, në perëndim nga oqeani Atlantik, në lindje oqeani Indian, në jug nga Kepi i Shpresës së Mirë. Vija bregdetare nuk është e përthyer, pasi ka pak gjiri dhe kepe. Është kontinenti i nxehtë. Bimësia dhe bota e gjallë shumë e pasur.	-Cilat janë veçortë që përcaktojnë ndarjen e e Afrikës Nënshaharane nga Afrika Veriore? -Çfarë është Greit Rift Vallej? -Pse klima dhe bimësia e rajonit është e pasur dhe e larmishme? -Cilat janë disa nga bimët dhe kafshët kryesore që rriten në këtë rajon?	Ndryshimi kryesor është ndikimi i krishterimit. Sipërfaqja e rajonit është 24.6 milion km ² . Hapja e kanali të Suezit ndikoi në zvogëlimin e rolit strategjik të kepit jugor. Njësitë fiziko-gjeografike janë: mali i Kilimanxharos, Kenias, Ruvenzori, Dragonit, shkretëtira e Abisinisë, Kalaharit, fusha e Kongos, Nigerit, Mozambikut etj. Lumenjtë janë: Kongo, Niger, Zambez, Limpopo, Oranxi etj..., por ka dhe ujëvara si ajo e Viktorias. Liqenet janë: Viktoria, Malavi, Niasa, Tanganiga etj. Klima e thatë, mesatare dhe tropikale.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Afrikës Nënshaharane dhe njësitë fiziko-gjeografike të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Afrikën Nënshaharane, Greit Rift Vallej.

Hapi III. Përforsimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Kepi i Shpresës së Mirë

Grupi 2. Ujëvara Viktoria

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Pse turistët e vizitojnë Afrikën Nënshaharane?

**Veçoritë e popullimit, kulturës dhe****zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënshahiane**Klasa: 8^{-të}**Tema mësimore: Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënshahiane****Situata e të nxënit:** Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe grafikun 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe ekonominë e vendeve afrikane?**Rezultatet e të nxënit:** në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja:

- Shpjegon nivelin e ulët të urbanizimit në Rajonin e Afrikës Nënshahiane;
- Përshkruan trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore të Rajonit të Afrikës Nënshahiane;
- Analizon ecurinë demografike të popullsisë së Rajonit;
- Shpjegon nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik dhe pse rajoni është i pasur me burime natyrore.

Fjalët kyçe: niveli i urbanizimit, vende në zhvillim**Burimet dhe mjetet mësimore:** Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.**Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare:** Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh**

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënshahiane**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1, 2 dhe grafikun 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe ekonominë e vendeve afrikane? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Veçoritë e popullimit dhe kulturës**2. Kontinenti i pasur, po i varfër?****Lexim i orientuar**

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull “ **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënshahiane** ” Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Veçoritë e popullimit dhe kulturës	Kontinenti i pasur, po i varfër?
------------------------------------	----------------------------------

Shkencëtarët besojnë se raca njerëzore i ka filluar e saj në Afrikë.

Afrika ka kaluar disa valë pushtimesh prej evropianëve të parë që arritën në vitet 1400, të cilët filluan të shfrytëzonin pasuritë natyrore dhe njerëzore të saj.

Popullsia e Rajonit ka ritmet më të shpejta të rritjes në botë.

Niveli i urbanizimit është më i ulët në botë (32.8%).

Popullsia shumë e varfër, jetëgjatësia rreth 52 vjeç. Afrika Nën-Sahariane ka trashëgimi të pasur kulturore dhe shpirtërore, me gjuhë të panumërta të fiseve vendase dhe gjuhët zyrtare të ish kolonizatorëve.

Besimi fetar është i krishterë, mysliman dhe besimet vendase praktikohen në bazë të riteve dhe miteve të kohës parakoloniale.

Rajoni është i pasur me burime natyrore si: bakër, hekur, magnez, zink, por zotëron dhe 50 % të rezervave të arit dhe sasi të mëdha uranumi dhe diamanti.

Pavarësisht burimeve është një nga rajonet më të varfëra me ritme të ngadalta të rritjes ekonomike.

Ajo hyn në grupin e vendeve në zhvillim që furnizojnë vendet qendrore me lëndë të parë, ushqime dhe fuqi të lirë punëtore.

Zhvillimi ekonomik nuk është në nivelet e pasurive që Afrika zotëron.

Periodha e gjatë e kolonizimit dhe paaftësia për të udhëhequr shtetet pas pavarësisë kanë ndikuar në gjendjen aktuale të tyre.

Problem mbetet ekzistenca e sektorëve të ekonomisë që nuk paguajnë taksa.

Shteti më i zhvilluar është Republika e Afrikës së Jugut, e cila njihet si një model dhe shpresë e mirë për të gjithë shtetet e tjera të rajonit.

Hapi III. Përforsimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Pse niveli i urbanizimit në Afrikën Nën-Sahariane është më i ulët në botë?
2. Cila është trashëgimia kulturore dhe shpirtërore e Afrikës Nën-Sahariane?
3. Pse në Afrikë bëhen përpjekje për uljen e nivelit të lindshmërisë?
4. Pse Afrika është kontinenti "i pasur", por "i varfër"?
5. Pse zhvillimi ekonomik i rajonit nuk është në nivelet e pasurive që ajo zotëron?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Lidheni me historinë. "Rajoni i Afrikës Nën-Sahariane ka qenë shtëpia e mijëra fiseve e popujve me kultura, gjuhë dhe besime të ndryshme". Përmendni dy prej tyre.

**Azia Lindore, veçoritë fiziko-gjeografike**

Shkollë dhe mjeshti	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Azia Lindore, veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Azisë Lindore?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon veçoritë e Azisë Lindore si një rajon i veçantë gjeografik; Përshkruan relievin dhe klimën e rajonit; Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Azisë Lindore. 		Fjalët kyçe: Lindja e Largët, Himalaje, Gobi, ariu panda.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e punës, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përforsimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mëimit**Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh**

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Azia Lindore, veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1, 2 dhe foton 1. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Azisë Lindore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Tiparet dalluese të rajonit të Azisë Lindore**2. Format kryesore të relievit dhe kushtet natyrore**

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen k olonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën "Di" shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën "Dua të di" shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën "Mësoj" shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
----	-----------	-------

<p>Azia lindore shtrihet në ekstremin lindor të kontinentit. Përbëhet nga ishuj dhe gadishuj të shumtë. Ariu Panda është kafsha më e njohur që rritet në Kinë.</p>	<p>-Pse pozita gjeografike e rajonit nuk është e favorshme? -Cilat janë veçoritë e formave kryesore të relievit dhe të kushteve natyrore? Pse jeta në Mongolinë Jugore dhe Kinën Qendërveriore është e vështirë? Pse klima e rajonit është ndër më të ashprat në botë?</p>	<p>Përfshin shtetet Kinë, Mongoli, Kore e Veriut, Kore e Jugut, Japoni dhe Tajvan. Japonia përbahet nga 4 ishuj të mëdhenj (Honsju, Hokaido, Sikoku dhe Kjusju), por dhe shumë të vegjël. Gadishulli më i madh është ai i Koresë. Rajoni quhet dhe Lindje e Largët. Zhvillimet teknologjike kanë rritur intesitetin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve. Njësitë fiziko-gjeografike janë: fusha e Kinës Veriore, fusha e Kinës Verilindore, rrafshnaltat e Tibetit, malet Tian Shan, Alltai, Kun Lun, shkretëtira e Gobit etj. Lumenjtë janë: Jance, Huanhe, Tone, Shinano, Han. Klima subtropikale, shkretinore, mesatare kontinentale. Bimësia shkretinore dhe pyjet gjethegjërë.</p>
--	--	---

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Azisë Lindore, njësitë fiziko-gjeografike dhe rajonet klimatike të saj. Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Lindja e Largët, Himalaje, Gobi, ariu panda.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Ariu Panda

Grupi 2. Shkretëtira e Gobit

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Pse rajoni është i preferuar për investime nga kompanitë e mëdha.



Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
<p>Tema mësimore: Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore</p>		<p>Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Lindore?</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet e e popullsisë së Rajonit të Azisë Lindore; • Shpjegon grupet etnike dhe fetare të rajonit; • Evidenton rajonet kryesore ekonomike në Rajonin e Azisë Lindore; • Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Lindore. 		<p>Fjalët kyçe: Kinë, Japoni, konfucianizmi, budizmi, Shangai</p>	

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.

Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabelle	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Lindore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabelle

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Karakteristikat e popullsisë së rajonit të Azisë Lindore

2. Burimet natyrore dhe zhvillimi ekonomik

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Karakteristikat e popullsisë së rajonit	Burimet natyrore dhe zhvillimi ekonomik
<p>Azia Lindore përmban rreth 25 % të popullsisë botërore.</p> <p>Rreth 90 % e popullsisë prej 1.3 miliard të Kinës është përqëndruar në një hapësirë fare të vogël të saj.</p> <p>Migrimi i brendshëm nga zonat rurale, malore dhe shkretinore drejt qyteteve në zonat bregdetare ka disa dekada që ndodh në këtë rajon.</p> <p>Mbipopullimi i qyteteve është një problem shqetësues, si dhe rritja e popullsisë është e lartë dhe shpesh janë ndjekur politika për uljen e numrit në familje, por Kina ka përsëri ka rritje të popullsisë.</p> <p>Shumica e shteteve janë etnikisht homogjene, ndërsa grupet kryesore etnike janë: kinezët, japonezët, mongolët, koreanët.</p> <p>Gjuhët kryesore që fliten janë: kinezçja, tibetiançja, japonisht, koreane, mongoliane, uigur etj.</p> <p>Besimet fetare kryesore janë konfucianizmi, budizmi, shintoizmi dhe shumë pak krishterimi.</p>	<p>Shumica e vendeve të rajonit kanë ekonomi tregu, përveç Koresë së Veriut që ka ekonomi plotësisht të kontrolluar nga shteti, ndërsa Kina dhe Tibeti kanë përshtatur ekonomi të përzierë.</p> <p>Japonia, pavarësisht e varfër në burime natyrore, renditet ndër vendet me zhvillim më të lartë ekonomik dhe sidomos për industrinë e teknologjisë së lartë. Ajo është ndër prodhuesit kryesor të makinave, kompjuterave, mjeteve të telekomunikacionit dhe është kthyer në fuqi ekonomike botërore.</p> <p>Korea e Jugut kaloi shumë shpejt nga një vend bujqësor në industrial të zhvilluar.</p> <p>Korea e Veriut ka investuar në prodhimin e makinerive, kimikate dhe armatime.</p> <p>Kina ka shfrytëzuar fuqinë e lirë punëtore dhe burimet e shumta natyrore, që konkuron shumë vende të botës me prodhimet dhe eksportet e saj.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë karakteristikat e popullsisë së rajonit të Azisë Lindore?

2. Cilat janë grupet kryesore etnike të rajonit?
3. Cilat janë rajonet kryesore ekonomike në Japoni?
4. Cilat janë karakteristikat e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Formuloni opinionin tuaj. Japonia pavarësisht se është e varfër në burime natyrore, renditet ndër vendet me zhvillim më të lartë ekonomik. Pse?



Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Lindore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Lindore		Situata e të nxënës: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Azisë. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Azisë Lindore?	
Rezultatet e të nxënës: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Plotëson hartën me emrat e vendeve që përbëjnë rajonin; • Përshkruan veçoritë e Rajonit të Azisë Lindore; • Identifikon vendet më të zhvilluara të rajonit. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Azisë Lindore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Azisë dhe Harta e Rajonit të Azisë Lindore , stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	25’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	15’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Lindore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënës në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Azisë. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e rajonit të Azisë Lindore ? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për rajonin e Azisë Lindore.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t’u ndjekur

1. Identifikoni Rajonin e Azisë Lindore
2. Plotësoni hartën me emrat e vendeve që përbëjnë rajonin.
3. Ngjyrosni me nga një ngjyrë secilin vend
4. Plotësoni hartën me nga një veçori kryesore të çdo vendi

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajoni i Azisë Lindore.
2. Cilat janë veçoritë kryesore të vendeve të Rajonit të Azisë Lindore?

Nxënësit mbajnë shënime përgjegjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartën “Rajoni i Azisë Lindore”, në “Portofolin e të nxënit me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.

**Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës****PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës Ora e tretë e projektit, me temë: Prezantimi dhe vlerësimi me notë i projektit		Situata e të nxënit: Nxënësit e dinë se ç'është projekti. Diskutim me nxënësit për komunikimin e përfundimeve të projektit.	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Organizon informacionin e marrë; • Realizon përmbledhjen e projektit; • Vlerëson realizimin e detyrave të projektit për anëtarët e grupit; • Analizon realizimin e plotë të projektit për parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. 		Fjalët kyç: Projekt kurrikular, rezultate të nxëni gjatë projektit, burime informacioni, grup pune, mjedis pune.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, Interneti, Literaturë gjeografike, disk, usb, laptop, video-projektor, postera, etj.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetari, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha
Hapi I. Parashikimi	Bashkëbisedim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Vëzhgim i detajuar/ Punë në grupe	10'
Hapi III. Përforcimi	Prezantim/ Diskutim/ Komunikim i përfundimeve /Mbajtje shënimesh	30'

Organizimi i orës së mësimit**Hapi I. Parashikimi: Bashkëbisedim**

Nxënësit e grupit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt, raportojnë te mësuesi përfundimet e punës së projektit dhe nëse kanë paqartësi për mënyrën e paraqitjes përfundimtare të projektit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Vëzhgim i detajuar /Punë në grupe

Klasa është ndarë në 8 grupe, ku secili grup ka temën e miniprojektit si më poshtë.

Grupi 1. Francë

Grupi 2. Gjermani

- Grupi 3. Itali
- Grupi 4. Britani e Madhe
- Grupi 5. Rusi
- Grupi 6. Japoni
- Grupi 7. SHBA
- Grupi 8. Kanada

Nxënësit e grupit të parë, të dytë, të tretë dhe të katërt bëhen gati për prezantimin e projektit.

Hapi III. Përforcimi: Prezantim/ Komunikim i përfundimeve/Diskutim/ Mbajtje shënimesh

Secili grup prezanton projektin me video-projektor/poster/ese

- Grupi 1. Francë
- Grupi 2. Gjermani
- Grupi 3. Itali
- Grupi 4. Britani e Madhe

Komunikon përfundimet e projektit.

Diskutim me të gjithë klasën për përfundimet e projektit.

Nxënësit mbajnë shënime përfundimet si dhe paqartësitë që kanë.

Nxënësit drejtojnë pyetje nxënësve grupit parë, të dytë, të tretë dhe të katërt që janë pjesë e projektit si dhe mësuesit nëse kanë paqartësi.

Vlerësimi: Vlerësim për nxënësit e grupit parë, të dytë, të tretë dhe të katërt realizimin dhe prezantimin final të projektit.



Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8^{-të}
Tema mësimore: Projekt: Shtetet më të industrializuara të Botës		Situata e të nxënit: Nxënësit e dinë se ç'është projekti. Diskutim me nxënësit për komunikimin e përfundimeve të projektit.	
Ora e katërt e projektit, me temë Prezantimi dhe vlerësimi me notë i projektit			
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Organizon informacionin e marrë; • Realizon përmbledhjen e projektit; • Vlerëson realizimin e detyrave të projektit për naëtarët e grupit; • Analizon realizimin e plotë të projektit për grupin e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë. 		Fjalët kyç: Projekt kurrikular, rezultate të nxëni gjatë projektit, burime informacioni, grup pune, mjedis pune.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, Interneti, Literaturë gjeografike, disk, usb, laptop, video-projektor, postera, etj.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetari, Historia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha
Hapi I. Parashikimi	Bashkëbisedim	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Vëzhgim i detajuar/ Punë në grupe	10'
Hapi III. Përforcimi	Prezantim/ Diskutim/ Komunikim i përfundimeve / Mbajtje shënimesh	30'

Organizimi i orës së mësimi**Hapi I. Parashikimi: Bashkëbisedim**

Nxënësit e grupit të pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë, raportojnë te mësuesi përfundimet e punës së projektit dhe nëse kanë paqartësi për mënyrën e paraqitjes përfundimtare të projektit.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Vëzhgim i detajuar /Punë në grupe

Klasa është ndarë në 8 grupe, ku secili grup ka temën e miniprojektit si më poshtë.

Grupi 1. Francë

Grupi 2. Gjermani

Grupi 3. Itali

Grupi 4. Britani e Madhe

Grupi 5. Rusi

Grupi 6. Japoni

Grupi 7. SHBA

Grupi 8. Kanada

Nxënësit e grupit të pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë bëhen gati për prezantimin e projektit.

Grupi i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt e ka prezantuar projektin në orën e tretë të zhvillimit të tij.

Hapi III. Përforsimi: Prezantim/ Komunikim i përfundimeve/Diskutim/ Mbajtje shënimesh

Secili grup prezanton projektin me video-projektor/poster

Grupi 5. Rusi

Grupi 6. Japoni

Grupi 7. SHBA

Grupi 8. Kanada

Komunikon përfundimet e projektit.

Diskutim me të gjithë klasën për përfundimet e projektit.

Nxënësit mbajnë shënime përfundimet si dhe paqartësitë që kanë.

Nxënësit drejtojnë pyetje nxënësve grupit të pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë që janë pjesë e projektit si dhe mësuesit nëse kanë paqartësi.

Vlerësimi: Vlerësim për nxënësit e grupit të pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë për realizimin dhe prezantimin final të projektit.



Azia Juglindore, veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Azia Juglindore, veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Azisë Juglindore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon veçoritë e Azisë Juglindore si një rajon i veçantë gjeografik; Përshkruan relievin dhe klimën e rajonit; Evidenton disa bimë dhe kafshë që rriten në këtë rajon; Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Azisë Juglindore. 		Fjalët kyçe: Azia Juglindore, Indokina, bima Raflesia Arnoldi.	

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.	Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.
--	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Azia Juglindore, veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënët në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Azisë Juglindore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Pozita gjeografike dhe rëndësia e Rajonit të Azisë Juglindore

2. Rajonet fiziko-gjeografike dhe kushtet natyrore të Azisë Juglindore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Rajoni shtrihet në jug të Kinës. Pjesa kontinentale përbëhet nga 2 gadishuj i Indokinës ku ndodhen shtetet Mianmar, Laos, Kamboxhia, Vietnam; dhe i Malajzisë ku ndodhet shteti i Malajzisë, si dhe shtetet ishullore Indonezi dhe Filipine. Është rajon me aktivitet sizmik dhe vulkanik të lartë. Tërmeti më i fortë ka qenë në Krakatau.	-Ku qëndron rëndësia e pozitës gjeografike të rajonit? -Cilat janë veçoritë e formave të relievit? -Cilat janë veçoritë e florës dhe faunës?	Indokina është emërtim gjeografik, e përdorur në fillim të shek XIX, për të identifikuar pjesën kontinentale të rajonit që njihet si Azia Juglindore. Njësitë fiziko-gjeografike: malet e Indokinës krijojnë tre vargje malorë (Anam Kordiliera, Bilaukaung, Arakan Joma). Ishujt njihen dhe me emrin Unaza e Zjarrtë e Paqësorit. Lumenjtë janë: Iravadi, Mekongu, Çao Pryh, lumi i Kuq etj. Klima tropikale, subtropikale, bregdetare dhe malore në kufi me Kinën. Flora dhe fauna është ekzotike dhe e shumëllojshme.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Azisë Juglindore dhe njësitë fiziko-gjeografikë të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Azia Juglindore, Indokina, bima Rafflesia Arnoldi.

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Vullkani Krakatau

Grupi 2. Bima Raflesia Arnoldi.

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Formuloni përfundimin tuaj. Çfarë ju duket interesante në Rajonin e Azisë Juglindore?



Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Juglindore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet e e popullsisë së Rajonit të Azisë Juglindore; • Shpjegon grupet etnike dhe fetare të rajonit; • Evidenton rajonet kryesore ekonomike në Rajonin e Azisë Juglindore; • Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Juglindore. 		Fjalët kyçe: Indonezianë, oriz, banane, mikroçipe, Singapori, Malajzia.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Juglindore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mëimit, si më poshtë;

1. Tiparet e popullsisë së Rajonit të Azisë Juglindore

2. Tiparet e zhvillimit ekonomik dhe perspektiva për të ardhmen

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore”** Gjatë leximit të mëimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabelle

Tiparet e popullsisë së Rajonit të Azisë Juglindore	Tiparet e zhvillimit ekonomik dhe perspektiva për të ardhmen
<p>Rajoni ka popullsi relativisht të lartë, sidomos Indonezia me rreth 250 milion banorë.</p> <p>Ishujt e Indonezisë dhe Filipinet kanë rreth 60 % të popullsisë, ndërkohë që pjesa kontinentale ka vetëm 40 %.</p> <p>Aktualisht ritmet e rritjes së popullsisë në rajon janë duke u ulur, megjithatë popullsia totale do të arrijë të dyfishohet pas rreth 60 vjetësh grupet më të mëdha etnike dominojnë në shtetet e tyre si: burmezët, taj, khemerët, vietnamezët.</p> <p>Me emrin indonezianë njihen njihen filipinët, malajot dhe indonezianët. Ka dhe shumë grupe të tjera etnike në rajon.</p> <p>Besimet kryesore fetare janë Hinduizmi dhe Budizmi, Islam dhe në Filipine mbizotëron krishterimi.</p> <p>Gjuhët kryesore janë të grupit Sino-Tibetina (Burmeze, Tai, Lao); grupi Austro-Aziatik (Mon, Khmer, Vietnameze); Indoneziane gjuhët Filipinase (Tagalog, Ilocano) etj. Në rajon përdoren dhe gjuhë të tjera.</p>	<p>Rajoni ka kontraste të mëdha ekonomike, ku disa shtete po ecin me ritme shumë të shpejta zhvillimi dhe të tjera kanë ritme të ngadalta.</p> <p>Malajzia është një prej shteteve, që po mbështetet në industrinë e reja dhe të teknologjisë së lartë, por pa lënë pas dore edhe bujqësinë.</p> <p>Bujqësia në Azinë Juglindore është ndër aktivitetet kryesore në luginat e lumenjve dhe prodhon për konsum të brendshëm dhe për eksport.</p> <p>Rreth gjysma e tokës mbillet me oriz, si dhe bimë të tjera që eksportohen janë: banane, kasava, kallam sheqeri, kafe, vaji i palmës etj.</p> <p>Rajoni ka psuri minerale si kallaj, hekur, magnez, volfram, por dhe naftë dhe gaz natyror.</p> <p>Singapori dhe Malajzia janë dy shtetet me zhvillim më të lartë ekonomik në industri dhe teknologji.</p> <p>Singapori po investon më shumë në industrinë e teknologjisë së lartë dhe përpunimit të naftës.</p> <p>Malajzia është eksportuesja kryesore e vajit të palmës, gomës, mjete elektronike, çimento, kimikate, ushqime të përpunuara, mikroçipave etj.</p> <p>Shtetet e tjera të rajonit janë më pak të industrializuara dhe ritmet e zhvillimit nuk janë shumë premtuese.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë karakteristikat e popullsisë së rajonit të Azisë Juglindore?

2. Cilat janë grupet kryesore etnike të rajonit?

3. Cilat janë rajonet kryesore ekonomike në Azinë Juglindore?

4. Cilat janë karakteristikat e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mëimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Formuloni opinionin tuaj. Malajzia është eksportuesja kryesore e mikroçipeve duke u kthyer në një qendër të rëndësishme të teknologjisë së lartë. Pse?



Rajoni i Azisë Jugore dhe veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Rajoni i Azisë Jugore dhe veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Azisë Jugore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> Dallon veçoritë e Azisë Jugore si një rajon i veçantë gjeografik; Përshkruan relievin dhe klimën e rajonit; Shpjegon rëndësinë që kanë musonet për ekonominë e vendeve të rajonit; Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Azisë Jugore. 		Fjalët kyçe: Rajoni i Azisë Jugore, musone	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Bilogjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30'
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Rajoni Azia Jugore dhe veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mëimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2, 3 dhe fotot 1, 2, 3. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për rajonin e Azisë Jugore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Tiparet dalluese të Rajonit të Azisë Jugore

2. Tiparet e relievit dhe kushteve natyrore të Azisë Jugore

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Rajoni ka formën e trekëndëshit, ku në perëndim deti Arabik, oqeani Indian në jug dhe në lindje. Shtetet e rajonit janë: India, Pakistani, Butan, Nepal, Bangladeshi, Sri Lanka dhe Maldivet. Këtu ndodhen dhe malet më të larta në botë Himalajet.	-Ku qëndron rëndësia e pozitës gjeografike të rajonit? -Cilat janë veçoritë e formave të relievit? -Pse në Azinë Jugore ka tre stinë? -Çfarë janë musonet? -Cilat janë bimët tipike të rajonit?	Rajoni ka zonat gjeografike si: mali Everest, Kashmiri, Khyber Pass, lumi Gang etj. Malet janë: Himalajat, Hindo-Kushit, Karakorumit, Gatet Lindore dhe Perëndimore. Pllaja e Dekanit, shkretëtira Thar, fusha e Indo-Gangut. Lumenjtë janë: Ind, Gang, Bramaputra etj. Klima tropikale, subtropikale, musonike dhe malore.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën "Dua të di" duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Azisë Jugore dhe njësitë fiziko-gjeografike të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Azia Jugore, musone.

Hapi III. Përforsimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Erërat musonike

Grupi 2. Mali Everest

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkoni informacion. Si ndikojnë musonet në jetën e banorëve të Indisë?



Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet e e popullsisë së Rajonit të Azisë Jugore; • Shpjegon grupet etnike dhe fetare të rajonit; • Evidenton rajonet kryesore industriale në Rajonin e Azisë Jugore; • Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore. 		Fjalët kyçe: Grafit, arra kokosi, Bombei, Delhi, Madra, Bangkok, Katmandu	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullsinë dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Karakteristikat e popullsisë së Rajonit të Azisë Jugore

2. Burimet natyrore dhe tiparet e zhvillimit ekonomik

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Azisë Jugore”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Karakteristikat e popullsisë së Rajonit të Azisë Jugore	Burimet natyrore dhe tiparet e zhvillimit ekonomik
<p>Rajoni i Azisë Jugore është një rajon i vogël nga sipërfaqja, por jo për nga numri i popullsisë që jeton në të.</p> <p>India shteti më i populluar i rajonit dhe i dyti në botë pas Kinës.</p> <p>Pakistani i pesti dhe Bangladeshi i gjashti në botë për numrin e popullsisë.</p> <p>Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e popullsisë janë: % e lartë e popullsisë rurale me familje të mëdha, besimet fetare që nxisin lindjet, niveli i ulët arsimor sidomos i vajzave, martesat në moshë të vogël etj.</p> <p>Niveli i urbanizimit mbetet i ulët dhe pse ka migrim të popullsisë drejt qyteteve dhe jeta rurale është shumë e vështirë.</p> <p>Besimet fetare kryesore në rajon janë: Hinduizmi, Budizmi, Islamizmi dhe Krishterimi.</p> <p>Rajoni ka larmishmëri gjuhësh me rreth 19 gjuhë kryesore që bëjnë pjesë në grupin Indo-European, Dravidiane, Sino-Tibetan</p>	<p>Azia Jugore është e pasur me burime natyrore që mbështesin ekonominë, por mbishfrytëzimi i disa prej tyre po shkakton probleme mjedisore dhe shterim të disa prej tyre.</p> <p>Rajon ka rezerva të naftës, gazit dhe uraniumit.</p> <p>India është eksportuesja kryesore në botë për hekur, por ka dhe rezerva të magnezit, kromit dhe gipsit.</p> <p>Sri Lanka është një nga prodhueset kryesore të grafitit, por dhe e pasur me minerale të çmuara si: safir, rubin etj.</p> <p>Rajoni është i pasur me lëndë drusore, por ky aktivitet ka çuar në shpyllëzime të mëdha dhe zhdukjen e shumë kafshëve.</p> <p>Gati 60 % e popullsisë merret me bujqësi që mbetet aktiviteti kryesor i ekonomisë.</p> <p>Produkte me vlerë janë: orizi, çaj, arrakokosi etj.</p> <p>Industria e lehtë, e rëndë dhe e teknologjisë së lartë është më shumë e zhvilluar në Indi, e cila preferohet nga kompanitë e huaja për shkak të numrit të madh të punëtorëve dhe pagave e taksave të ulëta.</p> <p>Rëndësi vitet e fundit po merr turizmi, i cili po siguron të ardhura të larta.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë karakteristikat e popullsisë së rajonit të Azisë Jugore?
2. Cilat janë grupet kryesore etnike dhe fetare të rajonit?
3. Cilat janë rajonet kryesore ekonomike në Azinë Jugore?
4. Cilat janë karakteristikat e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Jugore?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Formuloni opinionin tuaj. Azia Jugore është një rajon ku ritmet e rritjes së popullsisë kanë qenë historikisht të larta dhe vazhdojnë të mbeten të tillë. Pse?



Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Juglindore dhe Rajoni i Azisë Jugore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8--të
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Juglindore dhe Rajoni i Azisë Jugore		Situata e të nxënët: Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartën e Europës. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore?	
Rezultatet e të nxënët: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Shjegon rëndësinë e rajoneve të Azisë Juglindore dhe Azisë Jugore; • Plotëson hartat memece të Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore; • Përshkruan veçoritë e Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore. 		Fjalët kyçe: Rajon i Azisë Juglindore, Rajon i Azisë Jugore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, fletorja e veprimtarive praktike gjeografi 8, dërrasa e zezë, shkumësa, harta e Azisë, stilolasp, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetaria, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diskutim	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Diskutim/Plotësim harte	30’
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve/ Mbajtje shënimesh/ Diskutim	10’

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veprimtari praktike: Rajoni i Azisë Juglindore dhe Rajoni i Azisë Jugore**

Mësuesi përdor situatën e të nxënët në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të të vëzhgojnë hartat e Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore. Më pas drejton pyetjen: Cila është rëndësia e Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë. Më pas diskutojnë për Rajonin e Azisë Juglindore dhe Rajonin e Azisë Jugore.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim/Plotësim harte

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë.

Hapa për t'u ndjekur

1. Vëreni hartat fizike të Rajonit të Azisë Juglindore dhe Rajonit të Azisë Jugore. Identifikoni njësitë fizike në çdo rajon dhe plotësoni hartat me emrat e tyre
2. Identifikoni qendrat urbane më të zhvilluara në secilin rajon dhe plotësoni hartat me emrat e tyre.

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve/Mbajtje shënimesh/ Diskutim

Pasi është plotësuar harta nga nxënësit mësuesi drejton pyetjet e mëposhtme:

1. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Rajon i Azisë Juglindore, Rajon i Azisë Jugore.

Nxënësit mbajnë shënime përgjegjet e pyetjeve dhe më pas diskutohet me mësuesin për përgjigjet dhe paqartësitë që nxënësit kanë.

Paraqitet në klasë punimi i nxënësve për hartën që plotësuan.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Dokumentimi

Vendoseni, Hartat “Rajoni i Azisë Juglindore dhe Rajoni i Azisë Jugore”, në “Portofolin e të nxënësve me kompetenca”, lënda Gjeografi 8.



Australia dhe Oqeania dhe veçoritë fiziko-gjeografike

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Australia dhe Oqeania dhe veçoritë fiziko-gjeografike		Situata e të nxënësve: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2, 3 4. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Australinë dhe Oqeaninë?	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon veçoritë e Australisë dhe Oqeanisë, si një rajon i veçantë gjeografik; • Përshkruan relievin dhe klimën e rajonit; • Tregon në hartë nënrajonet dhe njësitë fiziko-gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë; • Shpjegon rolin e lumenjve Murrej dhe Darling në ekonomi për Australinë; • Identifikon disa nga bimët dhe kafshët kryesore që rriten në këtë rajon. 		Fjalët kyçe: Australia dhe Oqeania, Antarktida, qeni Dingo, djalli i Tasmanisë. Zogu Kivi, Manuka	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Gjuha shqipe dhe letërsia, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5 ‘
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Di/Dua të di/Mësoj	30’
Hapi III. Përforcimi	Shkrim i lirë (punë në grupe)	10’

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Australia dhe Oqeania dhe veçoritë fiziko-gjeografike**

Mësuesi përdor situatën e të nxënësve në fillim të mësimi. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartën 1 dhe fotot 1, 2, 3 4. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për Australinë dhe Oqeaninë? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Di/Dua të di/Mësoj

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tri kolona në fletoret e tyre. Më pas u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

1. Pozita gjeografike dhe relievi i Australisë dhe Oqeanisë

2. Hidrografia kushtet natyrore të rajonit

Në përfundim të leximit të secilës çështje duhet të plotësohen kolonat përkatë si më poshtë:

- Në kolonën “Di” shkruhen informacionet kryesore të njohura;
- Në kolonën “Dua të di” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuri shtesë;
- Në kolonën “Mësoj” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

DI	DUA TË DI	MËSOJ
Rajoni shtrihet në Hemisferën Jugore dhe përfshin Zelandën e Re, Guinea Papua dhe Antarktidën. Oqeania përbëhet nga Polinezia, Melanezia dhe Polinezia. Antarktida e mbuluar nga akulli.	-Ku qëndron rëndësia e pozitës gjeografike të rajonit? -Cilat janë veçoritë e formave të relievit? -Cilat janë veçoritë e florës dhe faunës të rajonit Australi - Oqeani? -Pse në rajon ka disa tipe klimash?	Dy shtetet më të zhvilluara të rajonit janë: Australia dhe Zelandën e Re. Njësitë fiziko-gjeografike janë: Alpet e Australisë, shkretëtirat Greit Sendi, Greit Viktoria dhe e Gibsonit, fusha Nularbor, në Zelandë fusha Kantërberi. Grupe shkencëtarësh vizitojnë here pas here Antarktidën për të kryer studimet e tyre. Lumenjtë janë: Murrej, Darling, Laklan etj. Klima dhe bimësia ndryshojnë në varësi të relievit dhe largësisë nga brigjet. Në Australi ndodhet dhe Barriera e Shkëmbinjve Korallor, më e madhja në botë që është rrezik nga ndotja.

Pas përfundimit të plotësimit dhe leximit të çdo kolone, mësuesja u përgjigjet pyetjeve në kolonën “Dua të di” duke diskutuar me nxënësit për përgjigjet e sakta të tyre.

Përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të Australisë dhe Oqeanisë dhe njësitë fiziko-gjeografikë të saj.

Në rubrikën fjalë kyç. Shkruani nga një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: Australia dhe Oqeania, Antarktida, qeni Dingo, djalli i Tasmanisë. Zogu Kivi, Manuka

Hapi III. Përforcimi: Shkrim i lirë (punë në grupe)

Mësuesi ndan klasën në dy grupe dhe secili grup do të zhvillojë detyrën si më poshtë.

Mësuesi shkruan në tabelë temat e shkrimit të lirë për secilin grup;

Grupi 1. Rifti Korallor në Australi

Grupi 2. Djalli i Tasmanisë

Lexohet detyra nga 3 nxënës nga secili grup.

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimi punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën kërkon informacion. Turistët shprehen se në Zeelandën e Re mund t’i përjetosh të gjitha stinët në një ditë. Pse?



Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë		Situata e të nxënit: Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullimin dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë?	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan tiparet e e popullsisë së rajonit të Australi-Oqeani; • Shpjegon grupet etnike dhe fetare të rajonit; • Evidenton rajonet kryesore industriale në Rajonin Australi-Oqeani; • Analizon veçoritë e zhvillimit ekonomik të Australisë dhe Zelandës së Re. 		Fjalët kyçe: Australia dhe Oqeania, Antarktida, qeni Dingo, djalli i Tasmanisë, zogu Kivi, Manuka	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, dërrasa e zezë, shkumësa, foto, harta, laptop, disk video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Stuhi mendimesh	5'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Lexim i orientuar, plotësim tabele	30'
Hapi III. Përforcimi	Teknika e pyetjeve	10'

Organizimi i orës së mësimit

Hapi I. Parashikimi: Stuhi mendimesh

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë**

Mësuesi përdor situatën e të nxënit në fillim të mësimit. Mësuesi i fton nxënësit të vëzhgojnë në libër hartat 1, 2 dhe fotot 1, 2. Më pas drejton pyetjen: Çfarë dini për popullimin dhe zhvillimin ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë? Disa nga përgjigjet e nxënësve mësuesi i shkruan në tabelë.

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i orientuar, plotësim tabele

Shkruaj në tabelë çështjet kryesore të mësimit, si më poshtë;

1. Tiparet e popullsisë dhe modelet e shpërndarjes

2. Ekonomia e Rajonit të Australi-Oqeanisë

Lexim i orientuar

Në vijim u shpjegoj nxënësve detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale do të lexojnë mësimin me titull **“Veçoritë e popullimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australisë dhe Oqeanisë”** Gjatë leximit të mësimit nxënësit plotësojnë tabelën si më poshtë;

Plotësim tabele

Tiparet e popullsisë dhe modelet e shpërndarjes	Ekonomia e Rajonit të Australi-Oqeanisë
<p>Rajoni ka sipërfaqe të madhe, por pjesa më e madhe e tij nuk është e përshtatshme për jetesë.</p> <p>Pjesa më e madhe e popullsisë së rajonit jeton në Australi, e përqëndruar në bregun lindor dhe juglindor të saj.</p> <p>Shkalla e urbanizimit në Australi është e lartë dhe popullsia si në shumë vende të zhvilluara po shkon drejt plakjes.</p> <p>Në Oqeani popullsia është akoma e re, ndërsa në shumë ishuj dendësia e popullsisë është e lartë.</p> <p>Shumica e njerëzve në Australi dhe Zelandën e Re jetojnë në qytete të mëdha si: Sidnej, Melburg, Uellington etj.</p> <p>Vendet e Rajonit kanë qenë koloni europiane, të cilët kryesojnë sot nga përbërja etnike.</p> <p>Vendasit në Zelandën e Re quhen maori dhe përbëjnë vetëm 2 % të popullsisë.</p> <p>Besimet fetare kryesore janë: krishterimi, Hindu dhe besimet vendase.</p> <p>Në Rajon fliten rreth 1200 gjuhë të ndryshme. Përveç gjuhëve vendase, një përqindje e madhe e popullsisë flet anglisht dhe frëngjisht, sipas zonave të kolonizuara nga këto shtete.</p>	<p>Australia dhe Zelanda e Re janë shtetet më të zhvilluara të rajonit.</p> <p>Ritmet e rritjes ekonomike dhe PPB i tyre është relativisht i lartë.</p> <p>Australia vetëm 10 % të territorit e ka të përshtatshëm për bujqësi, ka arritur të shfrytëzojë tokën me efikasitet dhe të ketë prodhime të larta.</p> <p>Australia ka dhe pasuri minerale të shumta si: bokside, opal, ar të cilësisë së lartë, zink, hekur, nikel etj., si dhe është ndër eksportueset kryesore botërore të këtyre mineraleve.</p> <p>Zelanda e Re ka tokë pjellore dhe ka të zhvilluar shumë bujqësinë dhe blegtorinë dhe eksporton produkte mishi dhe bulmetra. Ajo ka të zhvilluar peshkimin dhe eksporton peshkun ton, marlin, merluc etj.</p> <p>Zelanda e Re dhe ishujt e tjerë të Oqeanisë janë të varfër në burime minerale.</p> <p>Antarktida, megjithëse ka burime minerale nuk shfrytëzohet dhe është vendosur me marrëveshje, që të përdoret vetëm për studime nga shkencëtarët.</p> <p>Turizmi dhe shërbimet e tjera financiare bankare po sjellin të ardhura për rajonin.</p>

Hapi III. Përforcimi: Teknika e pyetjeve

Mësuesi u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme;

1. Cilat janë ndryshimet e popullsisë sipas rajoneve në Australi?
2. Cilat janë grupet kryesore etnike dhe fetare të rajonit?
3. Cilat janë rajonet kryesore industriale në Rajonin Australi-Oqeani?
4. Cilat janë karakteristikat e zhvillimit ekonomik të Rajonit të Australi-Oqeani?

Vlerësimi: Vlerësoj me notë 5 – 6 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.

Detyra dhe punë e pavarur

Në rubrikën mendoni në mënyrë kritike. Vëreni fotot 1, 2 dhe formuloni përfundime për ç'ka ato përfaqësojnë.



Përsëritje në nëntematikat: VII. Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore., VIII. Afrika Nënshaharane, IX. Azia Lindore, X. Azia Juglindore, XI. Azia Jugore dhe XII. Australia dhe Oqeania

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Përsëritje në nëntematikat: VII. Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore., VIII. Afrika Nënshaharane, IX. Azia Lindore, X. Azia Juglindore, XI. Azia Jugore dhe XII. Australia dhe Oqeania		Situata e të nxënit: Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor Diagramën e Venit.. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.	
Rezultatet e të nxënit: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Interpreton me ndihmën e hartës, pozitën gjeografike të rajonit dhe rolin e saj në marrëdhënie me rajonet e tjera; • Identifikon dhe interpreton në hartë veçoritë fiziko-gjeografike të rajonit; • Identifikon veçoritë e popullimit dhe kulturës së rajonit; • Analizon të dhëna dhe nxjerr përfundime për veçortitë e popullimit të rajonit dhe shkallën e ndikimit të migracionit në tiparet e popullsisë dhe kulturës së sotme. 		Fjalët kyç: rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore, rajoni i Afrikës Nënshaharane, rajoni i Azisë Lindore, rajoni i Azisë Juglindore, rajoni i Azisë Jugore.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti, harta mësimore, dërrasa e zezë, shkumësa, laptop, video-projektor, disk flipçart, fleta formati, lasp.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mëimit		Koha në minuta
Hapi I. Parashikimi	Diagrama e Venit/Diskutim	10'
Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja	Plotësim tabele/Diskutim	30'
Hapi III. Përforcimi	Diskutim	5'

Organizimi i orës së mëimit

Hapi I. Parashikimi: Diagrama e Venit/Diskutim

Shkruaj në tabelë temën mësimore: **Përsëritje në nëntematikat: VII. Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore., VIII. Afrika Nënshaharane, IX. Azia Lindore, X. Azia Juglindore, XI. Azia Jugore dhe XII. Australia dhe Oqeania**

Ora e mëimit fillon me prezantimin e çështjeve për diskutim, të sugjeruara nga nxënësit, sepse orën që vjen më pas do të zhvillohet provim dhe nxënësit parashtrajnë ato çështje të cilat duan dhe shpjegime.

Në vijim mësuesi shpjegon paqartësitë që kanë nxënësit.

Mësuesi paraqet në Power Point me video-projektor Diagramën e Venit. Ju keni marrë njohuri në këto nëntematika. Provoni sa të qëndrueshme i keni njohuritë. Nxënësit Diagramën e Venit e kanë dhe në libër.

1. Plotësoni diagramën e “Venit” për:

Afrika Veriore dhe Afrika Nënshaharane Azia Jugperëndimore

Tiparet dalluese	Veçoritë e përbashkëta	Tiparet dalluese
1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____	1. _____ _____ _____

Hapi II. Ndërtimi i njohurive të reja: Plotësim tabele/Diskutim

.Nxënësit ndërtojnë në fletore tabelën që kanë në libër dhe i plotësojnë.

1. Plotësoni tabelën e koncepteve për veçoritë dalluese të rajoneve të Azisë Lindore, Azisë Juglindore dhe Azisë Jugore:

Rajonet	Shtetet që përfshin	Karakteristikat dalluese të rajonit
Azia Lindore		
Azia Juglindore		
Azia Jugore		

Diskutim me nxënësit pasi kanë plotësuar tabelën.

Hapi III. Përforcimi: Diskutim

Mësuesi diskuton me nxënësit për mënyrën e hartimit të testimit që do të zhvillohet në orën që vjen më pas.

Vlerësimi: Vetëvlerësim. Vlerësoj me notë 4 – 5 nxënës të cilët përgjigjen saktë, janë pjesëmarrës aktivë në orën e mësimit punojnë saktë dhe në mënyrë të pavarur në detyrën e dhënë në klasë.



Testim në nëntematikat: VII. Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore., VIII. Afrika Nënshaharane, IX. Azia Lindore, X. Azia Juglindore, XI. Azia Jugore dhe XII. Australia dhe Oqeania

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: IV	Klasa: 8 ^{-të}
Tema mësimore: Testim në nëntematikat: VII. Afrika Veriore dhe Azia Jugperëndimore., VIII. Afrika Nënshaharane, IX. Azia Lindore, X. Azia Juglindore, XI. Azia Jugore dhe XII. Australia dhe Oqeania		Situata e të nxënësve: Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbledhës që është i detyrueshëm për çdo fund tremujori.	
Rezultatet e të nxënësve: në përfundim të temës mësimore nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • Formon shprehje të punës së pavarur; • Mëson të shprehë formimin me shkrim; • Demonstron aftësi për të interpretuar; • Përdor informacionin në mënyrën e duhur; • Analizon situata e lidhje të ndryshme; • Seleksionon informacionin sipas nevojës; • Demonstron aftësi për të krahasuar; • Shpreh aftësi për të nxjerrë përfundime. 		Fjalët kyçe: përshkrim, analizë, vlerësim, interpretim, përfundime.	
Burimet dhe mjetet mësimore: Fleta e testit me të njëjtin format për çdo nxënës.		Lidhja me fushat e tjera ndërkurrikulare: Matematika, Qytetari, Historia, Biologjia, TIK-u.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**FAZA I. 5 min**

Mësuesi orienton nxënësit lidhur me kërkesat e formatit të testit dhe shpërndan testet.

FAZA II. 40 min

Nxënësit marrin testin që është unik për të gjithë dhe punojnë gjatë gjithë orës.

FAZA III. 5 min (nga koha e pushimit)

Sapo bie zilha testet mblidhen dhe janë objekt i vlerësimit të vazhduar.

Pyetje për testim për dy grupe.

GRUPI I.

1. Ujëvarat e Viktorias janë në rajonin e Afrikës: **1 pikë**
 - a. Nënshaharane
 - b. Perëndimore
 - c. Veriore

2. Është lumi më i gjatë në Azi: **1 pikë**
 - a. Jance
 - b. Iravadi
 - c. Gangu

3. Korea bën pjesë në rajonin e Azisë: **1 pikë**
 - a. Juglindore
 - b. Lindore
 - c. Jugore

4. Është kafsha më e njohur që rritet në Kinë: **1 pikë**
 - a. Ariu Panda
 - b. Qeni Dingo
 - c. Djalli i Tasmanisë

5. Barriera e Shkëmbinjve Koralor, më e madhja në botë ndodhet në: **1 pikë**
 - a. Kinë
 - b. Indi
 - c. Australi

6. Shteti i Sri Lanka bën pjesë në rajonin e Azisë: **1 pikë**
 - a. Lindore
 - b. Jugore
 - c. Juglindore

7. Shkruani 4 njësi fiziko-gjeografike të rajonit Azisë Jugore: **4 pikë**
8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore, rajoni i Azisë Lindore, rajoni i Azisë Jugore, bima Raflesia Arnoldi. **4 pikë**
9. Rendit shtetet përbërëse të Rajonit të Azisë Lindore. **5 pikë**
10. Shpjegoni pse zhvillimi ekonomik i Afrikës Nënshaharane nuk është në nivelet e pasurive që ajo zotëron. **6 pikë**
11. Analizoni tiparet e zhvillimit ekonomik të vendeve të Rajonit të Azisë Jugore. **7 pikë**
12. Krahasoni Rajonin e Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore me Rajonin e Afrikës Nënshaharane. **8 pikë**

GRUPI II.

1. Rrafshnalta e Tibetit ndodhet në: **1 pikë**
 a. Kinë
 b. Kore
 c. Japoni
2. Ndajnë Kinën nga Azia Jugore malet: **1 pikë**
 a. Himalaja
 b. Zagrose
 c. Dragonit
3. India bën pjesë në rajonin e Azisë: **1 pikë**
 a. Juglindore
 b. Lindore
 c. Jugore
4. Është shteti model i zhvillimit për shtetet e Rajonit të Afrikës Nënsaharine: **1 pikë**
 a. Angola
 b. Afrika e Jugut
 c. Nigeri
5. Malajzia dhe Singapori janë dy shtetet më të zhvilluara industriale të rajonit të Azisë: **1 pikë**
 a. Juglindore
 b. Lindore
 c. Perëndimore
6. Shkurrja Manuka rritet në: **1 pikë**
 a. Korenë e Veriut
 b. Rusi
 c. Zelandën e Re
7. Shkruani 4 ishujt kryesor të Japonisë: **4 pikë**
8. Shkruani një fjali ku të shpjegoni kuptimin e fjalës: rajoni i Afrikës Nënsahariane, rajoni i Azisë Juglindore, Rajoni i Australi-Oqeanisë, musone, . **4 pikë**
9. Rendit shtetet përbërëse të Rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimor. **5 pikë**
10. Shpjegoni se në ç'mënyrë ekonomia e vendeve të Rajonit të Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore është e varur nga "Ari i Zi". **6 pikë**
11. Analizoni tiparet dhe modelet e shpërndarjes së popullsisë në Rajonin e Australi-Oqeanisë. **7 pikë**
12. Krahasoni Rajonin e Azisë Lindore me Rajonin e Azisë Juglindore. **8 pikë**

Konvertimi në pikë dhe vlerësimi me notë

Pikët	0 – 10	11 – 16	17 - 24	25 – 29	30 – 34	35 – 37	38 – 40
Nota	4	5	6	7	8	9	10